VENDIM
Nr. 462, datë 26.7.2018

PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2019–2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2019–2021, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PROJEKTDOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2019–2021

1. PRIORITETET AFATMESME NË PBA 2019–2021

1.1 Përmbledhje e trendeve afatmesme të zhvillimit makroekonomik

Ekonomia pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të qëndrojë mbi nivelin prej 4% edhe gjatë tri viteve të tjera 2019–2021. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.3% në vitin 2019 nga 3.8% e vlerësuar për 2017-n dhe 4.2% për 2018-n. Edhe në dy vitet e tjera, 2020 dhe 2021, ajo parashikohet të vijojë të përshpejtohet marxhinalisht me rreth 0.1 pikë përqindje në çdo vit, respektivisht në 4.4% në vitin 2020 dhe 4.5% më 2021.

Grafiku nr. 1. Rritja reale e PBB-së në %



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë periudhës afatmesme **rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet.**

Eksportet e shërbimeve, veçanërisht, shërbimet turistike, priten gjithashtu të vijojnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga **përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës**. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.

Konsumi final total për periudhën afatmesme (2019–2021) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 3.1% në vit, me një ngadalësim të lehtë të ritmit në vitet 2020 dhe 2021, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.7 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, **punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 2.5% në vit gjatë viteve 2019–2021**. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës.

Investimet totale në ekonomi parashikohen **të rriten në terma realë me mesatarisht rreth 5.3% në vit**, me një përshpejtim të lehtë në vitet 2020 dhe 2021, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindje në vit.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Megjithatë, për shkak të peshës së tyre ndaj strukturës së ofertës agregate, shërbimet pritet të kontribuojnë më shumë sesa sektorët e tjerë në rritjen e PBB-së.

- Politika fiskale për periudhën afatmesme 2019–2021 synon një **deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.7% të PBB-së për 2019-n, nga 2.0% i programuar për vitin 2018**; nivel prej 1.2% të PBB-së më 2020-n; dhe 0.5% në vitin 2021.

- Ky konsolidim fiskal synon që **niveli i borxhit publik si raport ndaj PBB-së të vijojë trajektoren e sigurt rënëse** të nisur që në vitin 2016. Borxhi publik pritet që të bjerë rreth nivelit 66.4% të PBB-së më 2019-n, 63.5% më 2020-n dhe më tej në 59.9% në vitin 2021.

- Njëkohësisht targeton në vijimësi një balancë primare pozitive dhe në rritje për vitet 2019–2021, respektivisht 1.0% më 2019-n nga 0.6% i targetuar në buxhetin 2018; 1.5% më 2020-n; dhe 2.2% në vitin 2021.

1.2 Prioritetet buxhetore afatmesme 2019–2021

Politikat fiskale në vitet në vijim do të vazhdojnë të mbështesin sipërmarrjen dhe sektorët strategjikë të rritjes. Nisma e qeverisë për rritjen e kufirit për aplikimin e tatimit fitimit nga 8 në 14 milionë qarkullim vjetor, duke ulur ngarkesën fiskale për mbi 91% të ndërmarrjeve në 0% ose 5%. Kjo politikë synon të krijojë më shumë nxitje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për t'u rritur dhe për të krijuar më shumë punësim. Përtej shkallës së reduktuar të TVSH-së për aktivitetet e hotelerisë në turizëm prej 6%, në këtë cikël trevjeçar nisim nxitjen e agroturizmit, me aplikimin e tatim fitimit në shkallën 5% dhe TVSH-së në shkallën 6% për shërbimet e akomodimit, si edhe përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për zhvillimet e agrotuzimit.

Këto politika synojnë jo vetëm nxitjen e turizmit, por edhe bujqësisë, e cila mbetet një tjetër sektor prioritar për këtë cikël trevjeçar, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor do të përfitojnë rimbursimin e TVSH-së në masën 20%, si fermerët, pa kufizime në lidhje me masën e qarkullimit vjetor, ndërkohë që bëhen subjekt i tatim-fitimit të reduktuar nga 15% në 5%.

Kjo politikë trevjeçare synon nxitjen dhe rritjen e ekonomisë për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet kuadrit të ri ligjor për nxitjen e investimeve strategjike, për zonat e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik dhe ligji për turizmin; të cilat synojnë përthithjen e teknologjive dhe investimeve të huaja private. Njëkohësisht, përmirësimi i klimës së biznesit dhe derregullimi lehtësojnë aksesin në shërbimet publike në kohë dhe kosto: platforma e unifikuar e qeverisë *e-Albania* po zgjerohet për të përfshirë tatimet, doganat, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Inspektoratin e Punës dhe një sërë institucionesh të tjera shtetërore.

Për të mundësuar zhvillimin ekonomik dhe përmirësuar kushtet social-ekonomike të popullsisë gjatë ciklit afatmesëm 2019–2021, qeveria do të vazhdojë financimin e prioriteteve të shpallura në programin e saj qeverisës 2017–2021, si vijon:

Punësimi ku synohet rritja e punësimit, si dhe përgjysmimi i diferencës midis papunësisë rinore e papunësisë së përgjithshme, nëpërmjet mbështetjes së programeve *start-up*, shkollimit, formimit profesional dhe korsive preferenciale në treg për punësimin e vajzave dhe djemve. Përgjatë kësaj periudhe, programet e nxitjes së punësimit dhe të arsimit e formimit profesional do të përfitojnë një financim të konsiderueshëm mesatarisht në masën 6 miliardë lekë në vit.

Infrastruktura e ujit ku synohet përmbushja e nevojave të përdoruesve të ujit, përmes:

- Shtrirjes së shërbimit të furnizimit me ujë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 75%;
- Shtrirjes së rrjeteve të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotura urbane, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 48%;
- Mbulimit të sipërfaqeve të tokave bujqësore me infrastrukturë ujitjeje e kullimi, që do të rritet me 40,000 ha për ujitjen dhe 70,000 ha për kullimin;
- Plotësimit të nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme do të jetë 100%.

Për periudhën 2019–2021, financimet për këtë prioritet do të jenë në rritje, nga 15.4 miliardë lekë më 2018-n, në **17.4 miliardë lekë** në vitin 2021.

Modernizimi i shërbimeve publike ku synohet reformimi i mënyrës së organizimit dhe strukturës të institucioneve përkatëse, futjes së teknologjisë dhe informatizimit të shërbimit, rekrutimit të stafit, si dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit, për ta bërë atë një shërbim cilësor, profesional dhe të shpejtë.

Për periudhën 2019–2021, financimet për këtë prioritet parashikohen mesatarisht me 1.3 miliardë lekë.

Menaxhimi i integruar i tokës, ku synohet:

- Ofrimi i drejtësisë për titujt e pronësisë duke përfshirë regjistrimin e tyre dhe kthimin dhe kompensimin e pronave;
- Unifikimi i regjistrave të pronës në kadastrën multifunksionale transparente dhe digjitale, përfshirë gjithë hartografinë e pronës;
- Pajisja e gjithë sipërfaqes së tokave bujqësore me certifikata pronësie;
- Përmirësimi i strukturave bujqësore edhe nëpërmjet lehtësimit të problemit të tokave djerrë (8% e tokës bujqësore), duke zbatuar instrumente fiskale nxitëse.

Për periudhën 2019–2021, financimet për këtë prioritet kapin vlerën prej mesatarisht 6 miliardë lekë në vit.

Investimet publike, ku synohet ruajtja e raportit prej **5% ndaj PBB-së**, do të kanalizohen në sektorët kyç për zhvillimin ekonomik dhe social, si:

- **Infrastruktura rrugore nacionale**

Përqendrimi i financimeve buxhetore për kompletimin e akseve të rëndësishme nacionale: Thumanë–Vorë–Kashar, Kashar–Rrogozhinë, Milot–Balldren, Orikum–Dukat dhe Kardhiq–Delvinë; si dhe *bypass*-et e Fierit dhe Vlorës për shumën totale prej 75 miliardë lekësh për periudhën 2019–2021.

- **Ujësjellës-kanalizime:**

Rritja e aksesit të popullsisë në shërbime cilësore furnizimi me ujë dhe kanalizime përmes financimit projekteve të ujësjellës-kanalizimeve për periudhën 2019–2021, me vlerën totale prej 32 miliardë lekësh. Sektori i ujit, i mbështetur nga modeli i financimit i miratuar në vitin 2018, parashikon rritjen e investimeve çdo vit, mesatarisht 4,3 miliardë lekë në vit përgjatë 2019–2021 dhe parashikon edhe sistemin e granteve në bazë performancën për të rritur përgjegjshmërinë dhe mbulimin e kostove të ndërmarrjeve të ujit.

- **Arsimi:**

Në arsimin parauniversitar do të financojë me prioritet projekte për ndërtime të reja, rikonstruksion/rindërtimin apo shtesa në objektet aktuale për më shumë se 170 objekte arsimore të tjera ose rreth 1500–1700 klasa/laboratorë mësimorë nga të cilat do të përfitojnë 50,000–55,000 nxënës dhe 3000–3500 mësues dhe edukatorë.

- **Shëndetësia:**

Synohet rikonstruktimi i plotë i 200 qendrave shëndetësore (100 qendra çdo vit) për periudhën 2019–2020, me një vlerë të përllogaritur mesatarisht 450 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe kompletohen me pajisje mjekësore.

Rikonstruksione të godinave spitalore me një vlerë 1.9 miliardë lekësh për periudhën 2019–2021. Në këtë projekt përfshihen: Spitali Lushnjë, Spitali Psikiatrik Elbasan, Spitali Vlorë, Berat, Lezhë, Pogradec, Mat.

- **Bujqësia:**

Rritja e produktivitetit në fermat e mëdha do të vazhdojë të mbështetet me më shumë se 7.8 miliardë lekë të siguruara nga programi IPARD. Këto fonde do të përmirësojnë prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore për të rritur sasinë dhe sigurinë ushqimore të tyre. Do të vazhdojmë investimet me synimin "ujë në çdo parcelë", si dhe përmirësimin e kullimit përmes thellimit të decentralizimit dhe rritjes së investimeve në sektor.

- **Infrastruktura rurale:**

"Rilindja rurale" do të jetë programi i integruar i zhvillimit të qendrave të banuara, zonave me interes turistik, apo i zonave rurale në të cilat do të synohet përmirësimi infrastrukturës, vlerësimi i traditave dhe trashëgimisë kulturore, rritja e nivelit të shërbimeve publike, përmirësimi estetik i qendrave të banuara që i jep mundësi zonave të caktuara rurale të kenë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm, duke krijuar njëherazi edhe premisat për zhvillimin e turizmit dhe agroturizmit. Për këtë qëllim do të investohen përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programe zhvillimi dhe infrastrukturë rurale për periudhën 2019–2021 rreth 48 miliardë lekë.

Në këtë kuadër programi 100 fshatrat do të synojë të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, si fokusim i qendërzuar i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore. Ky program do të mbështetet me rreth 900 milionë lekë fonde nga buxheti i shtetit për periudhën 2019–2021.

1.3 Parashikimi i ecurisë së projekteve koncesionare dhe të Partneritetit Publik Privat (PPP) me ndikim në buxhet për periudhën 2019–2021

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Gjithashtu, në këtë ligj përcaktohet se: "Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.".

Aktualisht, janë në fuqi 11 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), të cilat marrin mbështetje buxhetore, si dhe pritet që gjatë vitit 2018 të lidhen dhe 4 kontrata të reja nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Tabela X më poshtë jep parashikimet e efekteve buxhetore të këtyre projekteve koncesionare/PPP përgjatë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm 2019–2021.

Tabela 1. Koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore (në milionë lekë)

Lloji i Shpenzimit	Emertimi i Koncesionit/PPP	2018	2019	2020	2021
Kontrata te firmosura/ne vazhdim me mbeshtetje buxhetore					
Kapitale	Ndertimi, Operimi dhe Mirembajtja e Rruges Milot - Morine	0	0	839	839
Korrente	Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up)	876	876	876	876
Korrente	Ofrimi i shërbimeve të Integruara për ofrimin e setit të përsonalizuar të instrumenteve kirurgjikal, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale	1,560	1,607	1,655	1,705
Korrente	Ofrimi i Shërbimit të Dializës	655	655	655	655
Kapitale	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkise së Elbasanit	662	662	662	662
Kapitale	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	753	753	753	753
Kapitale	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	1,374	1,374	0	0
Korrente	Shërbimi i Skanimit në Dogana	1,616	1,664	1,711	1,762
Kapitale	Ndertimi i 17 Shkollave ne Arsimin Parauniversitar ne Bashkine e Tiranes	0	1,579	1,520	1,461
Kapitale	Ndertimi dhe Operimi i Rruges se Arbrit	0	2,500	2,500	2,500
Korrente	Inceneratori i Tiranes	1,039	1,364	1,364	1,364
Nentotali		**8,535**	**13,035**	**12,535**	**12,577**
Projekte te avancuara / dhene miratimi nga MoFE per mbeshtetje buxhetore*					
Korrente	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	886	886	886	886
Kapitale	Ndertimi dhe Operimi i Rruges Thumane-Vore	0	0	2,445	2,520
Kapitale	Ndertimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum - Dukat	0	0	355	1,143
Kapitale	Ndertimi dhe Operimi i Rruges Milot - Balldren	0	0	240	990
Nentotali		**886**	**886**	**3,927**	**5,538**
Totali Korrente		***6,633***	***7,053***	***7,148***	***7,249***
Totali Kapitale		***2,789***	***6,868***	***9,314***	***10,866***
TOTALI		**9,421**	**13,921**	**16,462**	**18,115**

** Përllogaritja e efekteve buxhetore për këto projekte është kryer me një kurs këmbimi 1 euro = 140 lekë, me qëllim reduktimin e riskut të kursit të këmbimit.*

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se "...*shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.*", rezulton se ky kufi respektohet përgjatë periudhës 2019–2021 sikurse evidentohet nga tabela 1 më poshtë:

Tabela 2. Respektimi i rregullit fiskal të ekspozimit të buxhetit ndaj pagesave të PPP-së për periudhën 2018–2021

Viti	2018	2019	2020	2021
Te Ardhurat Tatimore (ne milione lek)*	424,445	451,885	483,651	519,246
Pagesa Vjetore (ne milione lek)	9,421	13,921	16,462	18,115
% ndaj te ardhurave tatimore	2.4%	3.3%	3.6%	3.7%

** Vlerat e të ardhurave tatimore për periudhën 2018–2021 i referohen VKM-së nr. 25, datë 17.1.2018, "Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2019–2021".*

1.4 Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Mbështetur në parimet e transparencës dhe barazisë gjinore të miratuara me ligjin nr. 57/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe me qëllim afrimin e buxhetit me qytetarët, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2019–2021, është konsultuar me përfaqësues të shoqërisë civile në një tryezë të zhvilluar

gjatë muajit qershor 2018. Mesazhet kyç të kësaj tryeze gjenden në aneksin nr. 1 bashkëlidhur dokumentit.

Në të njëjtën kohë, vijon puna intensive për integrimin e mëtejshëm të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në kërkesat buxhetore të ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore. Informacion i hollësishëm në nivel treguesish performance dhe produktesh me bazë gjinore gjendet në aneksin nr. 2 bashkëlidhur këtij dokumenti.

2. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2019–2021

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) fillestar për periudhën 2019–2021[1] është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si: balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare e atë korrente. KMF-ja shërben si pikënisje për përcaktimin e tavaneve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019–2021 në nivel ministrie.

KMF-ja fillestare miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar (ose shkurt) të çdo viti dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi, nëse ka ndryshime substanciale, në dy momente kyç gjatë vitit: *i.* në muajin qershor, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavaneve të PBA-së për shpenzimet; si dhe *ii.* në muajin tetor, përpara dërgimit në Parlament të projektbuxhetit të shtetit.

KMF-ja përbëhet nga dy komponentë kryesorë: *i.* parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tri vitet e ardhshme; dhe *ii.* parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2019–2021 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë.

2.1 Zhvillimet makroekonomike

Zhvillimet në ekonomitë e huaja

Vlerësimet e fundit të bëra nga Eurostati për tremujorin e parë të vitit 2018[2] tregojnë se ekonomitë e Eurozonës dhe EU-28 kanë shënuar një rritje pozitive (prej 0.4%) përgjatë këtij tremujori, krahasuar me një tremujor më parë. Krahasuar më të njëjtin tremujor të një viti më parë, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 2.5% (për vendet e Eurozonës) dhe me 2.4% (për vendet e EU-28).

Rritja u përshpejtua në të gjitha shtetet, por sidomos në Gjermani (2.3%), Spanjë (2.9%) dhe Francë (2.1%). Disa prej ekonomive kryesore (vendet fqinje me Shqipërinë) si Greqia dhe Italia shënuan nivelin prej 1.9% dhe 1.4%, përkatësisht në tremujorin e katërt 2017 për Greqinë dhe në tremujorin e parë 2018 për Italinë. Ndërkohë, disa nga ritmet pozitive në lidhje me performancën e prodhimit të brendshëm bruto u shfaqën në vendet periferike të Eurozonës (Bullgaria me rritje 3.5% dhe Rumani me rritje 4.2%).

Aktiviteti ekonomik në Shqipëri është drejtpërsëdrejti i ndikuar nga ecuria ekonomike në mjedisin ndërkombëtar, veçanërisht në partnerët e saj tregtarë, si: Italia dhe Greqia, kryesisht nëpërmjet eksporteve drejt tyre, remitancave, si dhe investimeve të huaja direkte (IHD-të). Si pasojë e krizës globale, normat e rritjes u ulën ndjeshëm edhe në Shqipëri. Rritja reale në vitin 2009, u përgjysmua nga trendi i saj historik, por megjithatë, ndryshe nga pjesa dërrmuese e vendeve të tjera, rritja në Shqipëri vijoi të ishte pozitive, si rezultat i ekspozimit të kufizuar financiar në tregjet ndërkombëtare, si dhe të një politike fiskale ekspansioniste adekuate të iniciuar para krizës. Aktiviteti ekonomik në vend u ndikua nga pasojat negative të krizës në Eurozonë, veçanërisht në vendet fqinje, si: Italia dhe Greqia. Eksportet, remitancat dhe në njëfarë mase investimet e huaja direkte (IHD-të) ranë, duke u kthyer në kanalet kryesore të transmetimit të goditjeve të jashtme në ekonomi. Rritja ekonomike regjistroi normën e saj më të ulët prej 1.1% në vitin 2013.

Në saje të një rikuperimi të kërkesës së brendshme në reflektim të përmirësimit të besimit të agjentëve ekonomikë, si dhe e mbështetur nga politika të shëndosha fiskale dhe reformave strukturore, ekonomia rimori një farë impulsi pozitiv. Rritja ekonomike u përshpejtua gradualisht, duke arritur deri në rreth 3.84% në vitin 2017, e gjeneruar kryesisht nga një rritje e konsumit dhe investimeve private. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Financave të pasqyruara në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2019–

[1] Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2019–2021, i miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 25, datë 17.1.2018.

[2] Sipas vlerësimeve të EUROSTAT - tremujori i parë (botuar më 15 maj 2018).

2021, rritja ekonomike për vitin 2018 parashikohet të vijojë përshpejtimin gradual të saj në rreth 4.2%. Ndërsa për tri vitet në vijim 2019–2021 parashikohet një rritje mesatare prej rreth 4.4%.

Inflacioni në Eurozonë shënoi nivelin 1.9% (në terma vjetorë) përgjatë muajit maj 2018, në rritje prej nivelit 1.3% që u shënua në muajin paraardhës (prill 2018). Çmimi i energjisë shënoi ritmin më të lartë me rreth 6.1% në muajin maj 2018, e ndjekur nga grupi ushqime, alkool dhe cigare me 2.5%, e më pas me grupin shërbime me 1.6% dhe nga grupi i të mirave joindustriale me një nivel prej 0.3% përgjatë muajit maj 2018. Përgjatë muajit maj 2018, midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Eurozonës, normat më të larta të inflacionit u shënuan në Rumani (4.6%), Estoni (3.1%) dhe Hungari (2.9%), ndërkohë që nivelet më të ulëta u shënuan në Greqi (0.8%) dhe Irlandë (0.7%).

- ***Zhvillimet në Shqipëri***

Sektori real

Përgjatë vitit 2017, ekonomia e Shqipërisë ka treguar sërish shenja pozitive për ecurinë ekonomike në vend. Në vitin 2017, ekonomia në vend u rrit me 3.84%, krahasuar me një vitit më parë. Kontributin më të lartë e shënuan sektorët e "ndërtimit" (me 1.04 pikë përqindje) dhe sektori i "administrata publike dhe mbrojtja, arsimi, shëndetësia" (me 0.64 pikë përqindje). Ndërkohë, ekonomia në tremujorin e katërt të vitit 2017 u rrit me 3.36%, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Ndërsa për tremujorin e tretë të vitit 2017, kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit 2016, ekonomia shënoi një rritje prej 3.55%. Viti 2017 tregoi ritme pozitive dhe përshpejtuese të rritjes ekonomike duke qëndruar mbi rritjen e saj potenciale prej 3%. Grafiku i mëposhtëm pasqyron ecurinë ekonomike në vend që prej vitit 2006 deri në vitin 2017 (sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT-i).



Nga pikëpamja e ofertës agregate, përgjatë vitit 2017 degët e tjera me kontributin kryesor në rritjen e PBB-së ishin: "tregtia me shumicë dhe me pakicë etj.", me 0.63 pikë përqindje dhe "industria" me +0.45 pikë përqindje. Ndërkohë aktivitetet me kontributin më të ulët në rritje ishin: "informacioni dhe komunikimi" dhe "aktivitete të pasurive të paluajtshme" me vlerën 0.03 pikë përqindje.

Tabela më poshtë paraqet rritjen dhe kontributin sipas sektorëve të prodhimit në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2017 (dhe tremujorit të katërt 2017).

Sipas metodës së prodhimit	Rritja	Kontributi	Rritja	Kontributi
	(në % TIV-17 / TIV-16)		(në % 2017 / 2016)	
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	0.72	0.00	0.65	0.12
Industria	3.65	0.45	3.55	0.45
Ndërtimi	4.29	0.53	11.26	1.04
Tregtia me shumicë dhe me pakicë etj	3.96	0.66	4.05	0.63
Informacioni dhe komunikacioni	-6.53	-0.23	0.82	0.03
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	11.24	0.27	11.31	0.32
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2.64	0.15	0.54	0.03
Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike	4.14	0.28	1.78	0.10
Administrata publike dhe mbrojtja; arsimi; shëndetësia etj	5.60	0.64	5.71	0.64
Arte, argëtim dhe çlodhje, akt.të prodhimit të mallrave të familjeve	4.30	0.15	4.87	0.13
Taksat mbi produktet	4.10	0.47	3.58	0.45
PBB totale	**3.36**	**3.36**	**3.84**	**3.84**

Burimi: INSTAT, Shtator 2017

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja ekonomike përgjatë vitit 2017 në tërësi është ushqyer kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi final me një kontribut prej rreth 2.45 pikë përqindje, ashtu edhe investimet totale me një kontribut prej rreth 2.01 pikë përqindje. Po ashtu, eksportet neto kanë pasur një performancë pozitive (me rritje prej 7.09%) me një kontribut negativ prej rreth 1.15 pikë përqindje. Kryesisht rritja e besimit në ekonomi dhe kushtet më të favorshme financiare kanë mbështetur rritjen e konsumit dhe të investimeve private përgjatë vitit 2017.

Tabela më poshtë paraqet rritjen e çdo komponenti të kërkesës agregate, si dhe kontributin e secilit prej tyre në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2017 (dhe tremujorit të katërt 2017).

Sipas metodës së shpenzimeve	Rritja	Kontributi	Rritja	Kontributi
	(në % TIV-17 / TIV-16)		(në % 2017 / 2016)	
Konsumi Final	**2.34**	**-2.00**	**2.77**	**2.45**
Konsumi Privat	3.14	-2.28	2.86	2.18
Konsumi Aministratës Publike	-1.84	0.22	2.47	0.28
Investimet Bruto	**4.09**	**-1.33**	**7.74**	**2.01**
Kërkesa e Brendshme	**2.76**	**-3.25**	**3.81**	**4.36**
Eksportet Neto	**-37.51**	**7.77**	**7.09**	**-1.15**
Eksportet e Mallrave dhe Shërbimeve (FoB)	-3.77	1.12	8.92	2.91
Importet e Mallrave dhe Shërbimeve (FoB)	10.98	-5.57	8.24	4.00
PBB Totale	**3.36**	**3.36**	**3.84**	**3.84**

Burimi: INSTAT, Shtator 2017

Të dhënat e papunësisë sipas anketës tremujore të forcave të punës (LFS) tregojnë një rritje të punësimit dhe rënie të normës së papunësisë, si gjatë vitit 2017, ashtu edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Norma zyrtare e papunësisë[3] në tremujorin e parë të vitit 2018 për grup-moshat 15–64 vjeç është 13%, kundrejt 14.6% që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë. Edhe për grup-moshën e punës 15 vjeç e lart, shkalla e papunësisë zyrtare në tremujorin e parë të 2018-s shënoi vlerën prej 12.5%. Numri i personave të papunë në moshë pune (15–64 vjeç) në tremujorin e parë të vitit 2018 ishte 173,804 persona.

Në tremujorin e parë të vitit 2018 numri të punësuarve në moshë pune (15–64 vjeç) ishte 1,167,999 persona. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T1-2017), numri i personave të punësuar, u rrit me 39,055 persona ose 1.03%.

[3] Norma e papunësisë e regjistruar për grup-moshën 15–64 vjeç sipas klasifikimit të anketës së tregut të forcës së punës (ATFP të INSTAT-it) për tremujorin e parë të vitit 2018.









Sektori monetar

Konvergimi gradual i ekonomisë drejt potencialit të saj të rritjes, ka shtyrë gradualisht edhe nivelin e inflacionit drejt nivelit të targtuar. Kështu, përgjatë periudhës janar–maj 2018 inflacioni mesatar rezultoi të ishte në nivelin 2.0%. Në një këndvështrim më të gjerë, rritja e inflacionit u favorizua nga zgjerimi i kërkesës agregate dhe i presioneve të brendshme inflacioniste, por vijoi të frenohet nga nivelet e ulëta të inflacionit në vendet partnere dhe nga forcimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit.

Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e çmimeve për 3 vitet e fundit.



Bazuar në dinamikën e inflacionit, si edhe në parashikimet afatmesme për inflacionin dhe rritjen ekonomike, politika monetare ka vazhduar të jetë stimuluese. Norma bazë e interesit aktualisht është në nivelin më të ulët historik prej 1.0%.

Gjatë muajit prill të vitit 2018, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 0.1% krahasuar me muajin prill të vitit 2017. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 5.8%, ndërsa ai në valutë shënoi rënie prej 5.1%, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar. Gjatë muajit prill të vitit 2018, sasia e re kredisë së dhënë nga sistemi bankar në lekë shënoi rritje prej 76.2% kundrejt muajit paraardhës (mars) dhe një

rritje me 13.9% kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë (prill 2017). Ndërkohë sasia e re e kredisë së dhënë në euro u zvogëlua me 31.5% krahasuar me një muaj më parë (mars 2018) dhe, gjithashtu, u zvogëlua me 35.6% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë (prill 2017). Në aspektin sektorial, zgjerimi i kredisë është i përqendruar te segmenti i individëve, ndërkohë që kreditimi i bizneseve shfaqet i ngadaltë, i ndikuar si nga kërkesa e dobët e bizneseve, ashtu dhe nga oferta e shtrënguar e sektorit bankar.

Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e parë të vitit 2018 tregojnë se standardet e kredisë janë shtrënguar si për bizneset ashtu edhe për individët. Sipas madhësisë së biznesit vihet re se shtrëngimi i standardeve të kreditimit ka qenë i dukshëm në segmentin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndërkohë që për ndërmarrjet e mëdha standardet janë raportuar thuajse të pandryshuara. Për individët standardet e kredisë janë raportuar të shtrënguara, si në segmentin e kredisë për blerje banese, ashtu edhe për kredinë konsumatore. Kredia në lekë është zgjeruar me ritme të kënaqshme dhe është mbështetësi kryesor i zgjerimit të kredisë për sektorin privat. Ulja e normave të interesit të kredisë në nivele historike ka ndihmuar në zhvendosjen e kërkesës për kredi drejt monedhës vendase. Në prill 2018 rezulton se rreth 50.7% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 49.3% përbëhet nga kreditë në valutë. Kreditimi në monedhën vendase krijon më shumë hapësira për transmetimin e stimulit monetar në ekonomi, si dhe redukton rreziqet e euroizimit për stabilitetin financiar. Rënia në nivelin 13.46% e raportit të kredive me probleme në muajin prill tregon se bilancet e sektorit bankar po përmirësohen dhe se rreziku i kreditimit po vjen drejt reduktimit. Gjatë muajit prill të vitit 2018 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rënie me 2.1% krahasuar me prillin e vitit 2017. Stoku total i depozitave në lekë u ul me 3.1%, gjithashtu, ai në valutë ka rënë me 1.2 % krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2017. Në prill 2018 rezulton se rreth 47% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 53% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj.

Tregjet financiare kanë qenë të qeta dhe kanë vijuar të reflektojnë prime të përmbajtura rreziku dhe likuiditeti në tremujorin e parë të vitit 2018. Normat e interesit të kredive dhe depozitave vijojnë të luhaten pranë niveleve të ulëta të tyre, në një kohë që *yield*-et kanë shfaqur pririje graduale rënëse gjatë këtij tremujori. Normat e interesit në tregun ndërbankar në tre muajt e parë të këtij viti janë karakterizuar nga nivele të ulëta dhe të ngjashme me tremujorin e mëparshëm. Interesat e kërkuara nga bankat në tregtimin e fondeve midis tyre kanë rezultuar pranë normës bazë dhe treguesit e luhatshmërisë janë shfaqur në nivele të ulëta.

Interesat për depozitat e reja në lekë rezultuan mesatarisht 0.98% në tremujorin e parë të vitit 2018, duke qenë në nivele të afërta me tremujorin e kaluar (0.92%). Normat e interesit për depozitat e reja në euro kanë qëndruar pranë nivelit mesatar të tremujorit të fundit të vitit, duke shënuar 0.14%. Diferenca mes normave të interesit për depozitat në lekë dhe ato në euro ka ruajtur nivele të ulëta.

Interesi mesatar për kredinë e re në lekë për sektorin privat rezultoi 7.3% në tremujorin e parë, nga 6.8% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Norma mesatare e interesit të kredisë për bizneset ka rezultuar 7.7% nga 7.0% që ishte në tremujorin e katërt. Brenda segmentit të bizneseve, normat e interesit për kreditë për investime nuk kanë ndryshuar. Interesi mesatar për kredinë e re në euro për sektorin privat është ulur. Ai rezultoi 4.0% në tremujorin e parë, duke qëndruar lehtësisht nën nivelin mesatar prej 4.3% të tremujorit të katërt të vitit të kaluar. Sipas qëllimit të përdorimit, rënie kanë shënuar normat e interesit për kreditë për investime të bizneseve dhe ato konsumatore për individë. Diferenca e normës mesatare të kredisë në lekë kundrejt asaj në euro mbetet në nivele të ulëta, pavarësisht zgjerimit të shënuar në muajt e fundit. Në tregun primar të instrumenteve të borxhit të qeverisë, *yield*-et e bonove dhe të obligacioneve të thesarit kanë shfaqur ecuri rënëse. Ulja e *yield*-eve ka reflektuar përmirësimin e raportit ofertë/kërkesë, ku rritja e kërkesës së qeverisë për financim është përballur me një rritje më të shpejtë të ofertës së investitorëve, veçanërisht në ankandet e fundit. Rënia e *yield*-eve është shfaqur fillimisht në segmentin e bonove të thesarit. *Yield*-i 12-mujor rezultoi 2.39% në fillimin e muajit prill, nga 3.22% që shënonte në muajin janar. Reduktimi i *yield*-eve tek obligacionet ka qenë më i ngadaltë në ankandet e muajit shkurt, për t'u përforcuar në muajt mars dhe prill. *Yield*-et e obligacioneve 2- dhe 3-vjeçare u ulën në 2.98% dhe 3.40% në ankandet e fundit në muajin prill, nga 3.35% dhe 3.75% që ishin në muajin janar.

Politika e huamarrjes së qeverisë ka qenë e orientuar drejt instrumenteve afatgjata edhe në tremujorin e parë të vitit 2018, duke i shërbyer në këtë mënyrë zgjatjes së maturitetit të borxhit të brendshëm. Shtesa në huamarrjen e brendshme përgjatë kësaj periudhe ishte rreth 11.7 miliardë lekë,

73% e së cilës u realizua me instrumente afatgjata. Gjatë këtij tremujori, gamës së instrumenteve të borxhit iu shtua dhe huamarrja në bono thesari 3-mujore, me rreth 3.6 miliardë lekë, i cili mungonte në portofolin e letrave me vlerë që prej prillit 2017. Huamarrja e huaj neto në këtë tremujor ishte rreth 1.5 miliardë lekë.

Leku është forcuar me një ritëm më të shpejtë në tremujorin e parë të këtij viti, pas moderimit të mbiçmimit të tij të vërejtur në muajt e fundit të vitit të kaluar. Në terma nominalë efektivë, mbiçmimi vjetor i lekut u rrit në 5.5% në muajin mars, nga 4.1% që shënonte në muajin dhjetor. Ecuri të ngjashme ka ndjekur edhe kursi real i këmbimit, me një mbiçmim vjetor të përshkallëzuar në 5.3% në muajin mars, nga 3.8% në fund të vitit të mëparshëm. Leku është forcuar me një ritëm më të shpejtë se në muajt paraardhës kundrejt të gjitha monedhave të shportës, por ndikimin më të madh e ka dhënë forcimi i tij kundrejt monedhës evropiane. Tendenca e forcimit të monedhës vendase, e pranishme që në fund të vitit 2015, është gjerësisht në linjë me zhvillimet e treguesve makroekonomikë që përcaktojnë vlerën e saj. Kështu, përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend dhe prospekti më i mirë i saj në të ardhmen, si dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë, janë faktorët me natyrë fondamentale që kanë diktuar mbiçmimin e lekut në këtë periudhë. Nga ana tjetër, ecuria e kursit të këmbimit ka qenë, gjithashtu, subjekt i tepricave valutore të prodhuara nga agjentë apo sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të cilat në periudha të caktuara kanë diktuar shpejtësinë me të cilën ky mbiçmim është faktuar. Këto goditje kanë përgjithësisht natyrë afatshkurtër e kalimtare e nuk lënë pasoja të përhershme në ekonomi.

Sektori i jashtëm

Eksportet për periudhën janar–prill 2018, më specifikisht për eksportet e mallrave, referuar statistikave të tregtisë së jashtme (INSTAT), shënuan një rritje pozitive prej 16.8% në terma vjetorë. Gjithashtu, është e rëndësishme të evidentohet se që prej muajit gusht 2016 rritja e eksporteve totale të mallrave ka kaluar në territor pozitiv. Kontributin kryesor në rritjen vjetore të eksporteve për njëmbëdhjetëmujorin e ka dhënë grupi "Materiale ndërtimi dhe metale" me +4.5 pikë përqindje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të eksporteve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë, për tri vitet e fundit.

Rritja e Eksportit Prill 2015 - Prill 2018 (në %)



Importet e mallrave për periudhën janar-prill 2018 shënuan rritje prej 8.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në rritjen vjetore të importeve ka ndikuar më tepër grupi "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +3.1 pikë përqindje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të importeve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë, për tri vitet e fundit.



Deficiti tregtar për periudhën janar–prill 2018 është përkeqësuar me 0.8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 51.0%. Në katërmujorin e parë 2018, shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 67,7% të gjithë tregtisë. Në periudhën janar–prill 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë, janë: Italia (35,6 %), Gjermania (7,3 %), Greqia (6,8 %) dhe Kina (5,8 %).

3. PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2019–2021

3.1 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave për sigurimin e një kujdesi shëndetësor dhe mbrojtjes sociale sipas standardeve të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara në Republikën e Shqipërisë.

Për periudhën 2019–2021, sektori i shëndetësisë do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 3. Shpenzimet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vitet 2019–2021

Shpenzimet për sektorin e shëndetësisë në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
Në % ndaj PBB	2.9%	3.0%	2.8%	2.9%
Në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	10%	10%	10%	10%
Në vlerë nominale (mln lekë)	48,647	52,284	55,037	58,369
Nga të cilat të ardhurat nga FDSKSH-i	11,906	12,694	13,577	14,601

3.1.1 Prioritetet e sektorit për periudhën 2019–2021

- Në fushën e kujdesit parësor dhe dytësor synohet mbulimi universal i popullsisë me shërbim cilësor, diagnostikimi dhe parandalimi i sëmundjeve, si dhe shtimi i gamës së medikamenteve që trajtohen me recetë rimbursimi, reflektuar kjo në rritjen e jetëgjatësisë mesatare të grave dhe burrave në Republikën e Shqipërisë, mbi nivelet aktuale prej respektivisht 80 dhe 77 vjeç.

- 200 qendra shëndetësore të rikonstruktuara (100 qendra çdo vit) për periudhën 2019–2020, me një vlerë të përllogaritur mesatarisht 450 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe pajisen me pajisje mjekësore.

- Rikonstruksione të godinave spitalore me një vlerë 1.9 miliardë lekë për periudhën 2019–2021. Në këtë projekt përfshihen: Spitali Lushnjë, Spitali Psikiatrik Elbasan, Spitali Vlorë, Berat, Lezhë, Pogradec, Mat.

- Risi në këtë fushë është mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2019–2021, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen rreth 600 persona të trajtuar më parë me ndihmë ekonomike (NE) dhe pagesë të aftësisë së kufizuar.

Tabela 4. Përmbledhje e kërkesave buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitet 2019–2021

Permbledhje e Kerkesave Buxhetore per vitet 2019-2021				
(ne 000' LEK)	2018	2019	2020	2021
		PBA	PBA	PBA
Shpenzimet buxhetor sipas programeve				
Total	**59,591,951**	**62,279,988**	**64,820,416**	**66,657,826**
Programi 01110 (Plan/Menaxh/Administrimi)	459,790	486,490	488,000	489,000
Programi 07220 (Sherbime e Kujdesit Paresor)	9,284,186	9,581,568	9,590,616	9,820,918
Programi 07330 (Sherbime e Kujdesit Dytesor)	22,532,125	24,914,096	26,854,316	28,239,564
Programi 07450 (Shendeti Publik)	2,964,430	3,142,810	3,144,802	3,167,303
Programi 07460 (Sherbimi Kombetar I Urgjences)	565,670	352,300	717,613	738,800
Programi 10430 (Perkujdesi Social)	21,607,250	21,728,724	21,750,069	21,924,241
Programi 10460 (Perfshirja Sociale)	127,200	20,000	21,000	22,000
Programmi 01190 (Rehabilitimi dhe Integrimi I te Perndjekurve Politike)	2,051,300	2,054,000	2,254,000	2,256,000
Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik				
Total	**59,591,951**	**62,279,988**	**64,820,416**	**66,657,826**
600. Pagat	3,155,880	3,145,474	3,145,474	3,145,474
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	568,170	554,450	554,450	554,450
602. Mallrat dhe shërbimet	2,109,010	2,166,620	2,328,558	2,384,418
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	28,497,000	30,342,352	32,191,282	34,166,832
605. Transferta të jashtme	363,800	363,800	372,860	373,860
606. Transferta për familjet dhe individët	22,503,792	22,500,292	22,698,792	22,861,792
230. Aktivet e patrupëzuara	-	478,835	293,177	17,396
231. Aktivet e trupëzuara	2,394,299	2,728,165	3,235,823	3,153,604

3.1.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Programi "Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor"

- Rritja e numrit të vizitave në kujdesin parësor nga 6.4 milionë që janë aktualisht në 6.6 milionë në vitin 2021;
- Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë *(check-up)* për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
- Trajtimi me recetë rimbursimi një numër më i lartë pacientësh nga 475 mijë pacientë aktualisht në 478 mijë pacientë në vitin 2021.

Programi "Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor"

- Rritja e numrit të pacientëve të trajtuar nga 290 mijë pacientë në vitin 2018 në 330 mijë pacientë në vitin 2021;
- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë (200 pacientë më shumë çdo vit, për periudhën 2019–2021);
- Rritje e ndjeshme e numrit të pacientëve që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 170 mijë pacientë në vitin 2018, në 234 mijë në vitin 2021;
- Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve të rishtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh, nëpërmjet urgjencës;
- Reduktimit të kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
- Uljes nën 5.3 për 1000 lindje të gjalla të indeksit aktual të vdekshmërisë foshnjore;
- Përmirësimi i mëtejshëm i koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve më shumë se 49% që rezulton në vitin 2018;
- Rritja me më shumë se 40% e nivelit të numrit të pacientëve të vizituar për herë të parë brenda vitit nga personeli shëndetësor;

- Rritja me më shumë se 45% e numrit të grave mbi 35 vjeç të depistuara për kancer gjiri.

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesjes sociale në tri shtyllat kryesore të tij: ndihma ekonomike, paaftësia e kufizuar dhe shërbimet sociale. Më konkretisht, synohet:

- Zbatimi i skemës së re të vlerësimit dhe programeve të riintegrimit social do të sjellë reduktimin e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike nga 70 mijë familje aktualisht në 66.5 mijë familje në vitin 2021.

- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre do të reduktohet nga 158 mijë në 148 mijë në vitin 2021, kjo si rezultat i zbatimit të skemës së re të vlerësimit sipas modelit biopsikosocial. Ky sistem i ri shërbimi synon krijimin e një sistemi shërbimesh integruese të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesjes sociale.

Risi në këtë fushë është mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2019–2021, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen rreth 600 persona të trajtuar më parë me ndihmë ekonomike (NE) dhe pagesë të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE-së me paketa sociale shëndetësore. Implementimi i reformës do të sjellë:

- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve;

- Rritjen me 57% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;

- Rritjen me 12% të numrit të përfituese të grave kryefamiljare që marrin ndihmë ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;

- Rritja me më shumë se 66 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesjes sociale.

Investimet publike në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitet 2019–2021:

- 200 qendra shëndetësore të rikonstruktuara (100 qendra çdo vit) për periudhën 2019–2020, me një vlerë të përllogaritur mesatarisht 450 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe pajisen me pajisje mjekësore;

- Do të vijojë FAZA II e rehabilitimit të QSUT-së me mbështetjen e Bankës Botërore;

- Ndërtimi i Depos Qendrore të Barnave në QSUT, më një vlerë të plotë 270 milionë lekë, i cili ka filluar më 2018-n dhe pritet të përfundojë më 2019-n;

- Rikonstruksioni i ish-Kirurgjisë së Vjetër, Spitali Elbasan, me një vlerë totale prej 197 milionë lekësh, i cili pritet të përfundojë në vitin 2019;

- Rikonstruksion në Spitalin Rajonal Kukës, me një vlerë të plotë 197 milionë lekë, pritet të përfundojë më 2019-n;

- Rikonstruksione të godinave spitalore me një vlerë 1.9 miliardë lekë për periudhën 2019–2021. Në këtë projekt përfshihen: Spitali Lushnjë, Spitali Psikiatrik Elbasan, Spitali Vlorë, Berat, Lezhë, Pogradec, Mat;

- Shërbimi Kombëtar i Urgjencës do të vijojë blerjen e autoambulancave për vitet 2019–2021;

- Rikonstruksione në ambientet e institucioneve të kujdesit social me një vlerë totale 194 milionë lekë ku parashikohet ndërhyrje në Qendrën e Zhvillimit Durrës, Shtëpia e Fëmijës Shkodër, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë.

3.2 MINISTRINË E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Misioni i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë është krijimi i një sistemi arsimor që ka në qendër nxënësit me nevojat dhe interesat e tyre, duke u mundësuar arsimim bazë për të gjithë dhe barazi të shanseve për arsimim me qëllim ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që kërkon shoqëria; ridimensionimi i edukimit fizik dhe sportiv si pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore; përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në aktivitete rinore, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimmarrje.

Tabela 5. Shpenzimet për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në vitet 2019–2021

Shpenzimet për arsimin në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	PBA 2019	PBA 2020	PBA 2021
Sektori në % ndaj PBB-së	3.1%	3.3%	3%	3%
Sektori në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	10%	11%	11%	11%
MAS në mln lekë	38.374	39.306	40.894	40.654
Sektori i arsimit në mln lekë	50.697	58.182	60.331	60.141

3.2.1 Prioritetet për periudhën 2019–2021

- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve do të vijojë masat e saj të integruara për mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë, orientimin e kurrikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, si edhe mbështetjen për trajnim dhe punësim të kategorive të veçanta. Për periudhën 2019–2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të financojë me prioritet:

- Transportin e 28–30 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin e 10 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;

- Blerjen e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë;

- Për 1000–1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë do të garantohet trajtimi me kuotë ushqimore;

- Mbështetje e vazhdueshme për studentët, përmes mbulimit të shpenzimeve për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, krijimit të kushteve të përshtatshme të akomodimit në tetë "Shoqëritë e trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në rrethe" për rreth 8–10 mijë studentë, mbështetjes me bursa të rreth 100–120 studentë të rinj ekselentë që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së *Times Higher Education*;

- Në arsimin parauniversitar do të financojë me prioritet projekte për ndërtime të reja, rikonstruksion/rindërtimin apo shtesa në objektet aktuale për më shumë se 170 objekte arsimore të tjera ose rreth 1500–1700 klasa/laboratorë mësimorë nga të cilat do të përfitojnë 50,000–55,000 nxënës dhe 3000–3500 mësues dhe edukatorë;

- Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët përmes sigurimit të një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitar dhe sportit në tërësi në institucionet arsimore duke kontribuar kësisoj dhe në forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet buxheti për periudhën 2018–2021 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë sipas programeve buxhetore dhe sipas klasifikimit ekonomik.

Tabela 6. Përmbledhje e kërkesave buxhetore për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vitet 2019–2021

Përmbledhje e kërkesave buxhetore për 2019-2021				
(in 000' LEK)	2018 aktual	2019 Buxheti	2020 Buxheti	2021 plan
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
Total	**38,374,242**	**39,306,043**	**40,894,000**	**40,654,000**
Programi 01110 (PMA)	797,042	787,042	795,042	795,042
Programme 09120 (Arsimi Bazë)	22,174,527	22,065,000	22,937,000	22,637,000
Programie 09230 (Arsimi I mesëm I përgjithshëm)	7,094,732	7,489,043	7,662,000	7,462,000
Programi 09450 (Fonde për Arsimin e lartë)	7,305,203	7,444,958	7,869,958	8,058,998
Programi 09770 (Fonde për shkencën)	480,422	820,000	880,000	920,960
Programi 08140 (Sporti dhe rinia)	522,316	700,000	750,000	780,000
shpenzimet sioas klasifikimit ekonomik				
Total	**38,374,242**	**39,306,043**	**40,894,000**	**40,654,000**
600. Pagat	22,133,071	22,159,147	22,158,468	22,158,468
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	3,637,709	3,638,133	3,638,812	3,638,812
602. Mallrat dhe shërbimet	1,106,362	1,408,205	1,766,262	1,679,162
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	6,768,700	6,988,958	7,286,858	7,667,958
605. Transferta të jashtme	147,000	170,200	170,200	44,200
606. Transferta për familjet dhe individët	747,400	807,400	839,400	931,400
230. Aktivet e patrupëzuara	-	-	-	-
231. Aktivet e trupëzuara	3,834,000	4,134,000	5,034,000	4,534,000
Total				
Numri i Punonjësve Organik të Programit Buxhetor	*35,922*	*37,122*	*37,322*	*37,522*
Numri i Punonjësve me Kontratë të Programit Buxhetor	*1,542*	*1,542*	*1,542*	*1,542*

3.2.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Disa nga prioritetet e kësaj ministrie për 3 vitet në vijim, janë:

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2019–2020 synohet si më poshtë:

- Në arsimin parashkollor: rritja e aksesit të fëmijëve 3–6 vjeç që ndjekin arsimin parashkollor nga rreth 85% në vitin 2018, në nivelin 95–100% në vitet 2020–2021;
- Për një arsim gjithëpërfshirës, deri në vitin 2021 do të sigurohet arsim cilësor me synim 100% e fëmijëve të grup-moshës 6–16 vjeç të ndjekin arsimin 9-vjeçar;
- Rritja e treguesit të regjistrimit me 10–15% ose 350–500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuar;
- Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, do të synohet deri më 2021 dyfishimi i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuar;
- Në vitin 2021 synohet të sigurohet aksesi që 100% e fëmijëve 5–6-vjeçarë të ndjekin klasat ose grupet përgatitore të arsimit parashkollor;
- Reformimi i arsimit parashkollor, përmes miratimit të programeve për çdo grup-moshë, trajnimit të 900-1000 mësuesve/edukatorëve në vitin 2019;
- Reduktimi i braktisjes shkollore në arsimin bazë, duke synuar drejt braktisjes 0 nga 0.57% që rezulton në vitin 2018;
- Rritja e normës mesatare të kalueshmërisë nga 93% në vitin 2018, në 97.5 % në vitin 2021;
- Në vitit 2021, 98% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të regjistrohen në një nga format/ llojet e arsimit të mesëm, nga të cilët 65% të ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm gjimnaze dhe 35% arsimin profesional;
- Në krahasim me PISA 2012, ku jemi renditur në vendin e 56-të ndër 65 vende pjesëmarrëse, në PISA 2015 jemi renditur në vendin e 51-të, ndër 72 vende pjesëmarrëse, duke lënë pas 22 vende. Deri në vitin 2021 synohet të përmirësohet rezultati dhe renditja e Shqipërisë në vlerësimin ndërkombëtar PISA;
- Shërbimi psikosocial, aktualisht në shkollat e arsimit të mesëm të lartë ofrohet sipas kësaj norme: një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800–3,500 nxënës. Deri më 2021-n çdo shkollë e mesme

do të ketë një psikolog dhe/ose një punonjës social;

- Deri më 2021-n, 100% e shkollave do të kenë shërbimin e internetit nga niveli aktual prej 85%;
- Do të vijojë zhvillimi profesional përmes trajnimeve mbështetur mbi nevojat për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve shkollore si në nivel shkolle ashtu dhe ato të ofruara përmes sistemit kërkesë/ofertë. Në këtë skemë do të përfshihen edhe trajnimet e mësuesve të diasporës dhe minoriteteve. Përkatësisht trajnimi çdo vit 40–50 mësuesve të minoriteteve dhe trajnimi i 70–100 mësuesve dhe trajnerëve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe;
- Në vitin 2021, synohet arritja e standardit evropian, jo më shumë se 28–30 nxënës për klasë në zonën urbane, e cila do të mundësohet përmes investimeve në infrastrukturën shkollore.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2019–2020 parashikohet sa më poshtë:

- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë në nivel institucional e të programeve të studimit sipas kritereve e standardeve ndërkombëtare të HEAL-it, në përputhje me kërkesat e tregut lokal dhe kombëtar të punës;
- 100% e institucioneve të arsimit të lartë deri në vitin 2021, të sigurojnë akreditimin institucional e akreditim e programeve të studimit. Konkretisht, rritja e numrit të programeve që akreditohen nga 237 në vitin 2018 në 513 në vitin 2021;
- Rritja e kapaciteteve akademiko-kërkimore dhe stafit të institucioneve të arsimit të lartë në përmbushje të standardeve akademike;
- 95% e doktorantëve janë pjesë e stafeve me kohë të plotë e departamenteve më 2021-n;
- Synohet që 30% e financimit për kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë vjen nga ente private më 2021-n;
- Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% ndaj viti paraardhës (e matur me javë, muaj);
- 100% e studentëve ekselentë, studentë në nevojë të përfitojnë bursa, tarifa shkollimi zero dhe kredi studentore më 2021-n;
- Nxitja e punës kërkimore në institucionet e arsimit të lartë publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500–4000 kërkuesve gjatë periudhës 2019–2021, ku 30% e kërkuesve të jenë femra në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2019–2020 parashikohet sa më poshtë:

- Rritja e numrit të sportistëve të licencuar në federata shqiptare të sportit, nga 20 384 në vitin 2018, në 21 000 në vitin 2021;
- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në programin e praktikave të punës nga 600 në vitin 2019, në 900 të rinj në vitin 2021;
- Sigurimi i mbështetjes financiare për 25 federata olimpike dhe joolimpike në aktivitete evropiane, botërore dhe ballkanike me synim kualifikim për Lojërat Olimpike Japoni 2020;
- 20–25 sportistë elitarë të mbështetur financiarisht për rezultate të larta në aktivitete ndërkombëtare (medalje e fituara);
- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ përmes rindërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së 3 qendrave rinore rajonale.

3.3 MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMI RURAL

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synon të zbatojë programin e qeverisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke e ndërthurur atë me sektorë të tjerë, si: turizmi, infrastruktura dhe shërbimet, për nxitjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, nëpërmjet:

- uljes së kostos dhe rritjes së konkurrueshmërisë;
- menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe të ujitjes;
- kullimit e mbrojtjes nga përmbytja;
- përmirësimin e sigurisë ushqimore në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Për periudhën 2019–2021, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 7. Shpenzimet për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitet 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitet 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	PBA 2019	PBA 2020	PBA 2021

Në % ndaj PBB-së	0.66%	0.53%	0.48%	0.48%
Në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	2.20%	1.79%	1.75%	1.69%
Në mln lekë	10,944.6	9,387	9,607	9,685

3.3.1 Prioritetet e sektorit për periudhën 2019–2021

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2019–2021, janë si më poshtë:

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve përmes adaptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve;
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.

Në tabelën e mëposhtëm paraqitet shpenzimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas programeve buxhetore dhe sipas artikujve ekonomikë.

Tabela 8. Shpenzimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas programeve buxhetore dhe sipas artikujve ekonomikë

Përmbledhëse e Kërkesave Buxhetore Afatmesme				
(in 000' LEK)	2018	2019 Buxhet	2020 Buxhet	2021 Buxhet
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
Total	**10,944,628**	**9,387,000**	**9,606,989**	**9,684,989**
Planifikim menaxhim administrimi	413,728	513,000	523,000	533,000
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	2,256,100	2,040,838	2,104,316	2,124,316
Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes	2,208,122	1,595,800	1,705,800	1,715,800
Mbështetje për peshkimin	300,500	342,600	293,600	295,600
Zhvillimi rural duke mbështur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun	5,372,481	4,295,930	4,356,440	4,377,439
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	227,300	508,813	538,813	548,813
Menaxhim i qëndrueshëm i tokës bujqësore	26,000	40,000	35,000	40,000
Administrimi i ujërave	140,397	50,019	50,020	50,021
Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik				
Total	**10,944,628**	**9,387,000**	**9,606,989**	**9,684,989**
600. Pagat	1,576,391	1,736,381	1,736,381	1,738,381
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	269,081	307,932	307,932	307,932
602. Mallrat dhe shërbimet	1,630,156	1,605,400	1,579,140	1,632,214
605. Transferta të jashtme	34,000	35,000	35,000	40,000
606. Transferta për familjet dhe individët	2,565,000	1,437,287	1,583,536	1,601,462
230. Aktivet e patrupëzuara	94,611	42,420	40,000	40,000
231. Aktivet e trupëzuara	4,775,389	4,222,580	4,325,000	4,325,000

3.3.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Në fushën e "infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", synohet të realizohet:

- Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore që i ofrohet shërbimi i ujitjes nga 63.8% në 65% të totalit potencial prej 360 mijë hektarë tokë në vitin 2021;
- Mirëmbajtje vjetore të rrjetit kullues për 45 000 hektarë tokë si proces ciklik vjetor;
- Mundësimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovorë për 70 mijë hektarë tokë;
- Rehabilitimi/ndërtimi i rreth 30 km argjinatura të mbrojtjes nga përmbytja dhe erozioni.

Programi "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun", synon:

- Rritja e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe zhvillimit të zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së

veprimtarive ekonomike në zonat rurale, duke rritur:

- Numrin e fermerëve që përfitojnë nga skemat mbështetëse;
- Sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime;
- Arritja e standardeve të BE-së, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nëpërmjet shtimit progresiv, të:
- numrit të përfituesve nga skema e investimeve fizike në fermë për tri vite 430 ose (rreth 140 përfitues mesatarisht në vit);
- numrit të përfituesve nga skema e investimeve në agropërpunim 180 për tri vite ose 60 përfitues mesatarisht në vit;
- numrit të përfituesve nga skema e diversifikimit në fermë rreth 150 për tri vite (50 përfitues mesatarisht në vit).

Nëpërmjet programit "Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit" synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë, nëpërmjet:

- Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla, duke ulur konsiderueshëm numrin e jokonformiteteve të konstatuara në të gjithë zinxhirin ushqimor. Në vitin 2021 parashikohet të shpenzohen rreth 11% me shumë sesa shpenzimet aktuale për vaksinimin e 1.003.000 kafshëve.
- Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar, nëpërmjet:
- Rritjes së numrit të gjurmimeve nga 54.500 në vitin 2018 në 56.000 në vitin 2021.
- Shtimit të numrit analizave të kryera, duke arritur një mesatare vjetore prej rreth 5,250 analizash në vit.
- Do të kryhen inspektime të vazhdueshme (rreth 86 mijë inspektime në tri vitet e ardhshme dhe kontrollit dhe mbrojtjes nga parazitët në fushën e bujqësisë të rreth 25,000 ha mesatarisht);
- Rritjes së numrit të operatorëve që aplikojnë standardet HACCP në sigurinë ushqimore, nëpërmjet kryerjes të:
- Mesatarisht 89.000 inspektimeve; shtimit të numrit të gjobave të vendosura nga inspektimet në terren; numrit të bizneseve të mbyllura për mosplotësimin e kushteve të sigurisë ushqimore; numrit të rasteve të produkteve ushqimore të hequra nga tregu; numrit të ngarkesave të kthyera në pikat e inspektimit kufitar.
- Uljen e rasteve të sëmundshmërisë së njerëzve të shkaktuara nga kafshët;
- Uljen e rasteve të sëmundshmërisë së kafshëve në blegtori prej brucelozës, plasjes, tuberkulozit dhe LSD-në.

Risi në këtë sektor është rritja e numrit të fermerëve që mbështeten financiarisht dhe shtimit të masave të kontrollit për rritjen e sigurisë ushqimore. Sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit është një nga prioritetet kryesore në programin politik të qeverisë shqiptare. Kontrolli i parazitëve të ndryshëm siguron një mbrojtje sa më të mirë të bimëve dhe produkteve bimore duke rritur cilësinë dhe pastërtinë e tyre. Po ashtu mbrojtja e vendit nga përhapja e epidemive parazitare në bujqësi, ndihmon fermerin për të pasur një bimë të pastër, produkte cilësore dhe konkurrues në tregun vendas dhe të jashtëm. Garantimi i pastërtisë fitosanitare të prodhimit, është kusht i vendeve të BE-së.

3.4 MINISTRIA E DREJTËSISË

Ministria e Drejtësisë ka për mision hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale e civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Për periudhën 2019–2021, Ministria e Drejtësisë do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 9. Shpenzimet për Sektorin e Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për PBA 2019–2021

Shpenzimet për Sektorin e Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për PBA 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
Sektori i Drejtësisë (% ndaj PBB-së)	0.9%	0.95%	0.93%	0.9%
Sektori i Drejtësisë (në mln lekë)	**14,778**	**16,589**	**17,439**	**17,439**
Sektori i Drejtësisë (% ndaj buxhetit)	4.8%	5.2%	5.2%	5.2%
Ministria e Drejtësisë (% ndaj PBB-së)	0.6%	0.7%	0.7%	0.6%
Ministria e Drejtësisë (në mln lekë)	**10,446**	**11,871**	**12,410**	**12,414**
Ministria e Drejtësisë (% ndaj buxhetit)	3.28%	3.7%	3.7%	3.7%

Në fushën e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

3.4.1 Prioritetet e sektorit për periudhën 2019–2021

- Legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve dhe zonave informale. Rregullimi i çështjes së pronave në zbatim të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" dhe akteve nënligjore;
- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe siguron riintegrimin e tyre në shoqëri;
- Rritja e performancës së shërbimit të provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

Tabela 10. Shpenzimet për Ministrinë e Drejtësisë për PBA 2019–2021

Përmbledhje e Kërkesave Buxhetore				
(në 000' LEK)	2018 aktuale	2019 Buxheti	2020 Buxheti	2021 plan
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
Totali	**10,446,100**	**11,871,296**	**12,410,100**	**12,414,000**
Planifikim, Menaxhim, Administrimi	679,500	808,800	915,800	816,800
Qendra e Botimeve Zyrtare	72,300	67,400	71,000	71,500
Instituti i Mjekësisë Ligjore	89,000	82,000	82,300	83,000
Shërbimet për Çështjet e Birësimeve	16,500	14,700	15,200	15,700
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Provave	3,413,500	4,979,080	5,311,000	5,411,000
Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor	173,000	177,100	179,000	180,000
Sistemi i Burgjeve	5,832,100	5,573,916	5,667,000	5,667,000
Shërbimi i Provës	170,200	168,300	168,800	169,000
Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik				
Totali	**10,446,100**	**11,871,296**	**12,410,100**	**12,414,000**
600. Pagat	4,427,519	4,315,034	4,385,101	4,386,289
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	753,580	724,481	736,398	736,310
602. Mallrat dhe shërbimet	2,054,661	2,121,441	2,071,341	2,174,141
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	2,500,000	3,944,000	4,444,000	4,544,000
605. Transferta të jashtme	12,980	15,900	15,900	15,900
606. Transferta për familjet dhe individët	360	360	360	360
230. Aktivet e patrupëzuara	69,680	54,100	16,000	16,000
231. Aktivet e trupëzuara	627,320	695,980	741,000	541,000

3.4.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Programi "Sistemi i burgjeve" synon që të arrijë treguesit e mëposhtëm gjatë periudhës 2019–2021:

- Numri i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) sipas standardeve të ketë një trend rritës nga 42% që është aktualisht;

- Norma e recidivitetit (burra) të ketë një trend rënës nga 11% që është aktualisht;
- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend rënës nga 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Programi "Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të provave", për periudhën 2019–2021, synon:
- Sigurimi i një numri praktikash legalizimi pasurish informale prej 25,000 rastesh në vit;
- Realizimi i sigurt i të ardhurave nga legalizimi me një vlerë prej 1,150,000,000 lekësh çdo vit;
- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 68% që është aktualisht në 99% më 2021-n;
- Ndarja e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

3.5 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Misioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave shtetërore, programeve, normave dhe standardeve të përcaktuara kombëtare, në funksion të zhvillimit të sektorit të planifikimit dhe zhvillimit urban, në infrastrukturën rrugore dhe transportin detar, hekurudhor dhe ajror, ujësjellës-kanalizime, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimin postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjike e minerare dhe në sektorin e industrisë, me synim rritjen e vazhdueshme të mirëqenies së qytetarëve, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe promovues për investimet private dhe rritjen ekonomike, zhvillimin e hapësirës së lirë private, si dhe krijimin e kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit dhe sistemit të licencimit, duke përdorur burimet e disponueshme me eficiencë dhe efektivitet.

Për periudhën 2019–2021, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 11. Shpenzimet për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për PBA 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për PBA 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
në milion lekë	47,543	51,439	50,996	55,724
% ndaj PBB-së	2.9%	2.9%	2.7%	2.8%
% ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore	9.6%	9.8%	9.3%	9.7%

3.5.1 Prioritetet për periudhën 2019–2021

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: i. një portofoli të investimeve publike; dhe ii. përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës-kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara, si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovushme;
- Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

Tabela 12. Shpenzimet për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për PBA 2019–2021

Përmbledhje e Kërkesave Buxhetore për vitet 2019-2021				
(në mijë lek)	2018 Buxheti	2019 PBA	2020 PBA	2021 PBA
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
Totali	**47,542,630**	**51,438,581**	**50,995,643**	**55,723,843**
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	691,987	696,456	705,100	725,100
04520 - Transporti rrugor	24,415,501	27,319,733	26,173,971	31,653,971
04540 - Transporti Detar	150,260	410,000	878,000	483,000
04550 - Transporti Hekurudhor	1,273,680	2,230,000	2,240,000	2,250,000
04560 - Transporti Ajror	25,110	25,200	25,300	26,000
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	10,620,580	11,800,000	12,440,000	12,250,000
06220 - Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	2,564,272	3,464,272	3,464,272	3,464,272
04320 - Mbeshtetje për Energjinë	6,097,900	4,132,000	3,962,000	3,763,000
04430 - Mbështetje për Burimet Natyrore	553,200	305,000	285,000	285,500
04440 - Mbeshtetje per Industrinë	406,740	360,000	356,000	356,500
06180 - Planifikimi Urban	743,400	695,920	466,000	466,500
Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik				
Totali	**47,542,630**	**51,438,581**	**50,995,643**	**55,723,843**
600. Paga	921,742	921,742	921,742	921,742
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	192,458	192,458	192,458	192,458
602. Mallrat dhe Shërbimet	2,180,630	3,110,456	3,287,200	3,435,400
603. Subvencione	1,400,000	1,400,000	1,400,000	1,400,000
604. Transferta të brendshme	0	0	0	0
605. Transferta të jashtme	13,000	13,000	13,000	13,000
606. Transferta për individët dhe familjet	70,000	70,000	70,000	70,000
230. Aktivet e patrupëzuara	785,063	800,000	800,000	800,000
231. Aktivet e trupëzuara	41,979,737	44,930,925	44,311,243	48,891,243

3.5.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Programi "Transporti rrugor"

- Kompletimi i akseve rrugore nacionale, si: Rruga e Arbrit, Thumanë–Vorë–Kashar, Kashar–Rrogozhinë; Milot–Balldren; Orikum–Dukat; Kardhiq–Delvinë brenda vitit 2021 nëpërmjet partneritetit publik privat në kuadër të projektit "1 miliard";
- Rritja graduale e shpenzimeve aktuale për mirëmbajtje të rrugëve nacionale nga 3,000 euro në 11,000 euro në vit për km deri në vitin 2021;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 23%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.

Programi "Ujësjellës-kanalizime"

- Deri në vitin 2027, raporti mesatar i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë për të gjithë popullatën e vendit do të jetë 99% nga 78.8% në vitin 2017;
- Raporti mesatar i mbulimit me shërbime kanalizimi të ujërave të ndotura do të jetë 75% në vitin 2027, nga 51.66% në vitin 2017;
- Mbulimi me shërbim i ujërave të ndotura në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në 70% në vitin 2027;
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë më 2021, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2018;
- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 20% në vitin 2021;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2021.

Programi "Mbështetje për energjinë"

- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë i konsumatorit me energji elektrike;
- Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2009;
- Në vitin 2020 do të rritet eficienca e energjisë me 6.5% referuar vitit 2009.

Programi "Menaxhimi i mbetjeve urbane"

- Në vitin 2021, synohet që të trajtohen rreth 43% të mbetjeve me *landfill*-e sipas standardeve, nga

24% që parashikohet në fund të vitit 2018;

- Në vitin 2021, synohet të riciklohet rreth 20% e totalit të mbetjeve të prodhuara, nga 0.05% që parashikohet në fund të vitit 2018.

Programi "Planifikimi urban"

- Do të përfundohen brenda vitit 2019 të gjitha planet vendore për të 61 njësitë e reja vendore në bashkëpunim me qeverisjen qendrore, ekspertizën e huaj dhe kombëtare të cilat do të shërbejnë si bazë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social të tyre.

Programi "Transporti ajror"

- Rritja e standardeve dhe performancës së organit kombëtar të incidenteve/aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;

- Zbatimi i standardeve të njehsuara të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

Programi "Transporti detar"

Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integrimit në BE.

Programi "Transporti hekurudhor"

- Rikostruksioni i segmentit hekurudhor Tiranë–Durrës, si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas;

- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese, si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore.

Programi "Mbështetje për burimet natyrore"

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve;

- Realizimi në vazhdimësi i funksioneve të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional e efektiv të pasurive minerale, monitorimit minerar dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit, rritja e kontrollit për rehabilitimin minerar;

- Përmirësimi i transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Programi "Mbështetje për industrinë"

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspektimin dhe mbikëqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE-t.

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

- Rritja dhe përmirësimi i standardeve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme nën përgjegjësinë e MIE-s, në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.

- Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish-ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s. Rehabilitimi i territoreve të ish-ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim si parqe industriale.

- Promovimi te biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë-këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK-së dhe hartimi i raporteve mjedisore si dhe zhvillimi i disa ish-territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

3.6 MINISTRIA E BRENDSHME

Ministria e Brendshme ka për mision arritjen e standardeve të shtetit të së drejtës në fushën e sigurisë dhe rendit publik, në parandalimin dhe luftën ndaj krimit, në shërbim të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ministria e Brendshme synon të japë një kontribut në krijimin e një shteti më të sigurt, në të cilin mbizotëron respektimi i të drejtave të individëve të garantuara nga kushtetuta dhe ligjet, në krijimin e institucioneve ligjzbatuese të forta dhe të qëndrueshme, sipas standardeve evropiane.

Shpenzimet për Ministrinë e Brendshme në vlerë nominale, në përqindje ndaj PBB-së dhe në përqindje ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë për periudhën 2019–2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13. Shpenzimet për Ministrinë e Brendshme në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Brendshme në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
% ndaj PBB-së	1.28%	1.17%	1.04%	1.04%
Në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	4%	4%	4%	4%
Në vlerë nominale (mln lekë)	21,110	20,454.4	20,838.5	20,852.8
Nga të cilat për Policinë e Shtetit	16,879.9	15,975.3	16,491.7	16,501

3.6.1 Prioritetet për periudhën 2019–2021

Ministria e Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, "kontrollin e territorit" dhe "policimin në komunitet", të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja, të objekteve të rëndësisë së veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet evropiane në fushën e sigurisë. Gjithashtu, Ministria e Brendshme synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të digjitalizuar të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), të sistemit të Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike.

Tabela 14. Shpenzimet për Ministrinë e Brendshme për PBA 2019–2021

Kerkesat Buxhetore 2019-2021				
(ne 000' LEK)	2018 Buxheti	2019	2020	2021
		PBA	PBA	PBA
Shpenzimet Buxhetore Sipas Programeve				
Total	**21,110,038**	**20,454,410**	**20,838,558**	**20,852,868**
Programi "Planifikim/Menaxhim/Administrimi"	1,110,745	1,236,011	1,182,849	1,183,849
Programi Garda e Republikes	1,572,769	1,500,000	1,530,000	1,532,000
Programi Policia e Shtetit	16,879,984	15,975,310	16,491,709	16,501,019
Programi Prefektura dhe Funksionet e Deleguara	552,440	548,089	537,000	538,000
Programi Gjendja Civile	994,100	1,195,000	1,097,000	1,098,000
Shpenzimet Buxhetore sipas Artikujve Ekonomike				
Total	**21,110,038**	**20,454,410**	**20,838,558**	**20,852,868**
600. Pagat	12,346,910	12,346,910	12,346,910	12,361,220
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	2,143,952	2,143,952	2,143,952	2,143,952
602. Mallrat dhe shërbimet	3,528,076	3,587,580	3,981,728	3,981,728
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	-	-	-	-
605. Transferta të jashtme	13,500	13,500	13,500	13,500
606. Transferta për familjet dhe individët	480,600	453,600	453,600	453,600
230. Aktivet e patrupëzuara	22,000	4,720	4,720	4,720
231. Aktivet e trupëzuara	2,575,000	1,904,148	1,894,148	1,894,148

3.6.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Përgjatë 3 viteve të PBA 2019–2021, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj përmes:

- Rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit dhe terrorizmit;
- Përmirësimit rrënjësisht të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Rrjedhimisht, synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit, nga 1959 raste që parashikohen deri në fund të vitit 2018;
- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet. Ky objektiv do të arrihet kryesisht nëpërmjet rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit (nga 296,276 shërbime në vitin 2018 në 362,950 shërbime në vitin 2021), si dhe reduktimit të kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 23 minuta në vitin 2018 në 15 minuta në vitin 2021);
- Reduktimit të trafiqeve, krimit ndërkufitar dhe rasteve të imigrimit të paligjshëm. Ky objektiv do të arrihet kryesisht nëpërmjet reduktimit të kohës së procedimit (nga 30 minuta në vitin 2018 në 15 minuta në vitin 2021);
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja në përputhje me standardet evropiane (nga 90% në vitin 2018 në 96% në vitin 2021);
- Përdorimit në mënyrë efektive të përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil, në autorizimin dhe certifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Për arritjen e objektivit synohet reduktimi i kohës për trajtimin e kërkesës nga sistemi i RKGJ-së (nga 1.5 orë në vitin 2018 në jo më shumë se 0.5 orë në vitin 2021).

3.7 MINISTRIA E MBROJTJES

Ministria e Mbrojtjes ka për mision ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Politikën e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e vendit. Tavanet e paraqitura për PBA 2019–2021 paraqesin një nivel të përmirësuar mbështetjeje me burime financiare duke garantuar arritjen e kapaciteteve operacionale të deklaruara në kuadër të Aleancës së NATO-s në tri vitet e ardhshme.

Shpenzimet për Ministrinë e Mbrojtjes në vlerë nominale, në përqindje ndaj PBB-së dhe në përqindje ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë për periudhën 2019–2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 15. Shpenzimet për Ministrinë e Mbrojtjes në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Mbrojtjes në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
% ndaj PBB-së	1.20%	1.20%	1.29%	1.50%
Në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	4%	4%	5%	5%
Në vlerë nominale (mln lekë)	19,797.8	21,028.8	25,740.3	30,015.8

3.7.1 Prioritetet dhe treguesit e performancës për periudhën 2019–2021

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA-së në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA-së.

Me këtë buxhet, Ministria e Mbrojtjes, synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA-së, duke:
- Zhvilluar kapacitetet e FA-së në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- Vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- Zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- Modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike;
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA-së, në

operacionet e aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO-ja mund të ndërmarrë;

- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA-së për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e emergjencave civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-së dhe BE-së;

- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

Tabela 16. Shpenzimet për Ministrinë e Mbrojtjes për PBA 2019–2021

Kerkesat Buxhetore 2019-2021				
(ne 000' LEK)	2018 Buxheti	2019	2020	2021
		PBA	PBA	PBA
Shpenzimet Buxhetore sipas Programeve				
Total	**19,618,103**	**20,968,849**	**24,617,799**	**27,268,406**
Programi 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,204,565	1,215,000	1,207,300	1,310,300
Programi 02120 Forcat e Luftimit	6,873,135	7,109,835	10,232,500	11,905,057
Programme 130 Arsimi Ushtarak	598,100	600,050	620,000	600,050
Programme 02150 Mbështetja e Luftimit	4,798,290	5,833,410	6,182,000	7,082,000
Programme 07340 Mbështetje për Shëndetësinë	869,675	845,554	855,999	855,999
Programme 10270 Mbështetje për Ushatarakët	4,974,600	5,060,000	5,200,000	5,200,000
Programme 1 Emergjencat Civile dhe Rezervat	299,738	305,000	320,000	315,000
Shpenzimet Buxhetore sipas Artikujve Ekonomike				
Total	**19,618,103**	**20,968,849**	**24,617,799**	**27,268,406**
600. Pagat	5,773,212	5,786,202	5,786,202	5,786,202
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	956,126	956,126	956,126	956,126
602. Mallrat dhe shërbimet	5,079,900	7,169,521	7,579,971	9,427,578
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	5,104,600	5,190,000	5,330,000	5,330,000
605. Transferta të jashtme	194,000	177,000	178,000	181,000
606. Transferta për familjet dhe individët	390,265	390,000	390,000	390,000
230. Aktivet e patrupëzuara	-	-	-	-
231. Aktivet e trupëzuara	2,120,000	1,300,000	4,397,500	5,197,500

** Diferencat që rezultojnë mes tavanit të alokuar dhe atij të shpërndarë nga Ministria e Mbrojtjes në formatet e kërkesave buxhetore, rezultojnë nga mosalokimi i fondit në zërin e shpenzimeve kapitale.*

3.8 MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Ajo përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, për bashkërendimin e ndihmës së huaj, të tregtisë, strehimit dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Kjo ministri harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergjimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror dhe strehim.

Për periudhën 2019–2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 17. Shpenzimet për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për PBA 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për PBA 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
në milion lekë	60,869	62,967	65,669	65,687
% ndaj PBB-së	3.7%	3.6%	3.5%	3.3%
% ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore	12.3%	12.0%	11.9%	11.5%

3.8.1 Prioritetet për periudhën 2019–2021

- Mirëplanifikim i shpenzimeve dhe miradministrim i të ardhurave me qëllim mbështetjen e një rritje ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme;
- Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke u ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë;
- Nxitja e eksporteve dhe rritjes së konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet promovimit të eksporteve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe mbështetjes financiare me anë të granteve;
- Rritja e pjesëmarrjes së punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta me mbi 50% të totalit të përfituesve nga programet e nxitjes së punësimit (femrat, të rinjtë 16–30 vjeç, emigrantët e kthyer me probleme ekonomike, të papunët afatgjatë, romët, personat me aftësi të kufizuar, jetimët, gra kryefamiljare), si dhe integrimin në këto programe të punëkërkuesve të papunë që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie;
- Ofrimi i formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, rritja e mundësisë për të nxënit gjatë gjithë jetës si për burrat dhe për gratë dhe përshtatja me mundësitë e punësimit të ofruara nga tregu i punës;
- Rritja e aksesit në arsimin e mesëm profesional duke synuar që në vitin 2021 të tërhiqen 20.1% e nxënësve që ndjekin ciklin e arsimit të mesëm, nga 19.5% që parashikohet të arrijë më 2018-n;
- Mundësimi i strehimit për rreth 42% të familjeve të pastreha të regjistruara deri në vitin 2021, krahasuar me 9% që parashikohet të strehohen deri në fund të vitit 2018.

Tabela 19. Shpenzimet për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për PBA 2019–2021

Përmbledhje e Kërkesave Buxhetore për vitet 2019-2021				
(në mijë lek)	2018 Buxheti	2019 PBA	2020 PBA	2021 PBA
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
Totali	**60,868,921**	**62,967,327**	**65,669,189**	**65,686,789**
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,780,245	1,294,919	1,205,000	1,043,000
01120 - Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	542,500	497,000	498,000	544,000
01130 - Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	330,000	330,000	330,000	330,000
01140 - Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,782,000	2,683,000	2,683,000	2,783,000
01150 - Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	3,805,155	3,612,227	3,623,220	3,723,220
01160 - Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	89,800	82,900	83,000	83,100
04130 - Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	670,300	771,300	781,000	779,000
04160 - Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	364,500	365,500	367,500	368,500
10220 - Sigurimi Shoqeror	44,640,750	46,882,000	49,314,600	49,037,959
10550 - Tregu i Punes	2,117,731	2,253,400	2,451,000	2,501,000
04170 - Inspektimi ne Pune	199,140	199,300	210,000	210,500
09240 - Arsimi i Mesem (profesional)	2,996,800	3,439,781	3,566,469	3,516,469
06190 - Strehimi	550,000	550,000	550,000	560,000
Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik				
Totali	**60,868,921**	**62,967,327**	**65,669,189**	**65,686,789**
600. Paga	5,287,610	5,287,610	5,287,610	5,287,610
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	924,565	924,565	924,565	924,565
602. Mallrat dhe Shërbimet	3,739,261	4,404,210	4,857,410	5,451,651
603. Subvencione	490,000	550,000	490,000	490,000
604. Transferta të brendshme	44,738,639	46,882,000	49,314,600	49,037,959
605. Transferta të jashtme	271,778	271,778	271,778	271,778
606. Transferta për individët dhe familjet	1,200,537	1,200,537	1,200,537	1,200,537
230. Aktivet e patrupëzuara	138,520	140,000	140,000	140,000
231. Aktivet e trupëzuara	4,078,011	3,306,627	3,182,689	2,882,689

3.8.2 Përmbledhje e treguesve kyç të performancës

Programi "Menaxhimi i shpenzimeve publike" synon të arrijë treguesit e mëposhtëm të performancës:

- Të ardhurat tatimore parashikohen të kapin nivelin 26% të PBB-së në vitin 2021, nga 25.7% të parashikuara për vitin 2018;

- Niveli i borxhit publik parashikohet të ulet në 59.9% të PBB-së në vitin 2021, nga niveli 68.7% i PBB-së i parashikuar për vitin 2018;

- Përmirësim të dukshëm në renditjen e Shqipërisë tek Indeksi i Hapjes së Buxhetit *(Open Budget Index),* nga 50 pikë prej 100 (maksimumi) në vitin 2017, në të paktën 58 pikë prej 100 (maksimumi) në vitin 2021.

Gjatë periudhës 2019–2021, nëpërmjet programit "Tregu i punës" synohet të punësohen në total 7,260 të papunë nga grupet e veçanta, të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale rreth 2,250 të rinj të sapodiplomuar në arsimin e lartë; të punësohen në total rreth 900 gra kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe vajza nëna; si dhe të trajnohen nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit rreth 5,100 të papunë të trajtuar më parë me ndihmë ekonomike.

Programi "Arsimi i mesëm profesional", për periudhën 2019–2021, synon:

- Rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2021, krahasuar me 42% në vitin 2018;

- Rritjen e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.300 nxënës më 2018-n, në 3.600 nxënës në vitin 2021;

- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 40% e totalit në vitin 2018 në 55% e totalit në vitin 2021;

- Rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 90 nxënës në vitin 2018 në 120 nxënës në vitin 2021.

Gjatë periudhës 2019–2021, programi "Mbështetje për zhvillim ekonomik", synon:

- Promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panaire ndërkombëtare dhe *road show* promovuese, vizita në kompani (*after care*), si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike;

- Zgjerimin e numrit të bizneseve të profileve të ndryshme që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit (255 biznese të mbështetura për periudhën 2019–2021), me qëllim që të rritet konkurrueshmëria e tyre si në tregun e brendshëm dhe në atë të jashtëm.

Programi "Strehimi", për periudhën 2019–2021, synon që:

- Të mbështesë për herë të parë rreth 3280 familje të pastreha nëpërmjet skemës së kredive të subvencionuara nga shteti përgjatë periudhës 2019–2021;

- Të rrisë numrin e familjeve të pastreha që përfitojnë bonus qiraje nga 381 përfitues të parashikuar në vitin 2018 në 1009 përfitues në vitin 2021;

- Të rrisë numrin e familjeve që i përmirësohen kushtet e banimit me rreth 1318 familje përgjatë periudhës 2019–2021;

- Të rrisë numrin e familjeve që përfitojnë banesa sociale me qira në objekte të adaptuara me rreth 260 familje përgjatë periudhës 2019–2021;

Gjatë periudhës 2019–2021, programi "Menaxhimi i të ardhurave tatimore", synon:

- Rritjen me rreth 10% në vit mbledhja e të ardhurave tatimore dhe jotatimore përgjatë periudhës 2019–2021;

- Rritjen e raportit të zbulueshmërisë nga kontrollet e kryera nga administrata tatimore te bizneset;

- Zgjerimin e kontrollit të verifikimit në terren nëpërmjet strukturave të hetimit tatimor, nga 60 mijë inspektime në vitin 2018 në 65 mijë në vitin 2021.

Programi "Menaxhimi i të ardhurave doganore", përgjatë periudhës 2019–2021, synon:

- Rritjen e numrit të deklaratave doganore të procesuara në kanalin blu (në import) nga 10% e totalit të deklaratave doganore të parashikuara më 2018-n, në 17% të parashikuara për 2021;

- Rritjen e numrit të deklaratave doganore të procesuara në kanalin jeshil (në eksport) nga 8% e totalit të deklaratave doganore për eksport të parashikuara më 2018 në 14% të parashikuara për 2021;

- Shkurtimin e kohës mesatare së shpenzuar për 1 zhdoganim me rreth 6% më pak në vitin 2021 krahasuar me vitin 2017;

Gjatë periudhës 2019–2021, programi "Sigurimi shoqëror", synon:

- Rritjen e raportit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore ndaj mbështetjes buxhetore për skemën e sigurimeve shoqërore nga 61:39 në vitin 2018 në 62:38 në vitin 2021;

- Përmirësimi i raportit të punësuar (kontribues) për pensionist (përfitues) nga 1.21 të punësuar për pensionist në vitin 2018 në 1.26 të punësuar për pensionist në vitin 2021.

3.9 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin.

Për periudhën 2019–2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të përmbushë objektivat e synuar përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 20. Shpenzimet për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për PBA 2019–2021

Shpenzimet për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për PBA 2019–2021				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
në milion lekë	2,259	2,371	2,410	2,414
% ndaj PBB	0.14%	0.14%	0.12%	0.12%
% ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore	0.45%	0.45%	0.44%	0.42%

Në fushën e turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë. Ndërsa për fushën e mjedisit, synohet

sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

3.9.1 Prioritetet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për periudhën 2019–2021

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor;
- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2021 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Reduktimi i ndotjes nga shkarkimet industriale për lejet e tipit A dhe B dhe i rreziqeve nga aksidentet industriale sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- Forcimi i mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit dhe forcimi i menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve ujore;
- Përmirësimi i menaxhimit efektiv dhe sigurimi i vazhdueshëm i mbrojtjes dhe administrimin e zonave të mbrojtura.

Tabela 21. Përmbledhje e kërkesave buxhetore për vitet 2019–2021 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për PBA 2019–2021

Përmbledhje e Kërkesave Buxhetore për vitet 2019-2021				
(në mijë lek)	2018 Buxheti	2019 PBA	2020 PBA	2021 PBA
Shpenzimet buxhetore sipas programeve				
89	01110		2021	0	4,300	3,000	**7,300**	14,500	0	1,500	16,000	**0**	14,500	4,300			4,500	23,300	**0**
	Komisioni Prokurimit Publik																		
90	01110	**Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi**	2019		0	9,000	**9,000**	18,000	0		18,000	**5**	18,000	0			9,000	27,000	**5**
90	01110		2020		0	9,000	**9,000**	20,000	0		20,000	**0**	20,000	0			9,000	29,000	**0**
90	01110		2021		0	9,000	**9,000**	21,500	0		21,500	**0**	21,500	0			9,000	30,500	**0**
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**																		
91	01110	**Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi**	2019	0	0	0	**0**	6,537			6,537	**5**	6,537	0			0	6,537	**5**
91	01110		2020	0	0	0	**0**	6,537			6,537	**0**	6,537	0			0	6,537	**0**
91	01110		2021	0	0	0	**0**	6,537			6,537	**0**	6,537	0			0	6,537	**0**
92	**Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit**																		
92	01110	**Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi**	2019	0	0	0	**0**			2,000	2,000	**0**	0	0			2,000	2,000	**0**
92	01110		2020	0	0	0	**0**					**0**	0	0			0	0	**0**
92	01110		2021	0	0	0	**0**					**0**	0	0			0	0	**0**

95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-																	
95	01110	**Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi**	2019	43,000	5,000	131,550	**179,550**				**30**	43,000	5,000			131,550	179,550	**30**
95	01110		2020	73,000	6,200	-2,000	**77,200**				**0**	73,000	6,200			-2,000	77,200	**0**
95	01110		2021	115,000	18,080	-2,000	**131,080**				**0**	115,000	18,080			-2,000	131,080	**0**

ANEKSI 3

Raport përmbledhës / Tryeza e Konsultimit "Përparësitë dhe Politikat në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me mbështetjen e Asistencës Teknike të Bashkimit Europian për mbështetjen e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë(OSFA) organizoi në 20 Qershor 2018, tryezën e konsultimit me fokus rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në përparësitë e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019 – 2021, në kuadër të Strategjisë së Menaxhimit të Politikave Fiskale (SMPF) 2014-2020.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërrmarrë angazhim maksimal për një nga shtyllat kryesore të SMFP 2014-2020 për fuqizimin e sistemeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe dhe mekanizmave të llogaridhënies, me qëllimin e përmirësimit të cilësisë së shpenzimeve buxhetore që sigurisht, përtej shpenzimeve, përfaqësojnë dhe shërbimet, me objektivin parësor "Qytetari në qendër të buxhetit" duke e konsideruar shoqërinë civile si aktor kyç në këtë proçes.

MFE - Paneli drejtues dhe moderues: Ministri z. Arben Ahmetaj, Zv/Ministër z. Erion Luci, Sekretar i Përgjithshëm zj. Geraldina Prodani, Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit Znj.Mimoza Dhëmbi, Drejtori i Buxhetit z.Gentian Opre.

Pjesëmarrës: Përfaqësues të MFE dhe Ministrive të Linjës(MSHMS, MASR, MD, MM, MIE, MBZHR, MK), institucione shtetërore (Avokati i Popullit, Garda e Republikes, Komisionieri i të dhënave personale), FSHZH etj) Përfaqësues nga OSHC-të, Përfaqësues nga Universitetet Private dhe Publike; Delegacioni Europian në Shqipëri, OSFA, ekipi i Asistenca teknike e BE-së në mbështetje të SMFP. Pjesëmarrja u shënua e gjerë dhe pati mbi 85 të pranishëm, nga 60 pjesëmarrës të parashikuar.

Z. Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë - *Mesazhet kyçe*

- PBA mishëron të gjitha politikat dhe prioritetet e qeverisë. Buxheti synon të nxisë reformat dhe investimet strukturore në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare. Politikat makro dhe ato fiskale janë prioritet për zhvillimin.
- Konsideratë primare në PBA inputet dhe outputet, për të bërë transparente çfarë shpenzohet dhe çfarë ju ofrohet qytetarëve.
- Qytetarët dhe përfaqësuesit kanë nevojë të kuptojnë më mirë financat publike për rritje besimi të dyanshëm, dhënie të kontributit.
- Organizatat e Shoqërisë Civile të sfidojnë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe qeverisjen qëndrore në shumë sektorë e çështje të prekshme e me ndikim të drejtëpërdrejtë te qytetari;
- Buxheti synon të maksimizojë përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit, përmes rritjes së shërbimeve dhe mirëqenies, për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe rritjen e aksesit nga kryeqyteti deri në skajet më të largëta të vendit.

ARSIMI	
MFE & ML-të Angazhime/Rekomandime	*OSHC Diskutime/Rekomandime*
- Arsimi rreth 6 miliardë lekë, input i konsiderueshëm me output të diskutueshëm. Ku shkojnë? Cfarë output nxjerr sistemi ynë ? - Investimi në arsimin e lartë duhet të lidhet domosdoshmërisht me tregun e punës - PBA vijon mbështetjen e arsimit profesional; orientimin e kurrikulave te nevojat e tregut të punës dhe modernizimin e tyre - Shkollat si qendër komunitare, financim 20 – 25 milionë lekë/vit. Fonde për kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta për rreth 1000-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë. - Mbulimi i shpenzimeve të transportit të mësuesve dhe nxënësve rriten me 30 % në PBA - Kompensimi i teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës.	- Fondet për arsimin e lartë të kufizuara (referencë publikut); infrastrukturë e dobët - Mungesë e mekanizmave për fuqizimin e institucioneve të arsimit të lartë. Qeveria ndihmë për ngritjen e kapaciteteve. - Konsultimi me publikun të jetë më i gjerë dhe gjithëpërdshirës, ka mangësi. - Shkolla si qendër komunitare. +220 shkolla të përfshira, kërkojnë alokim fondi të posaçëm. - Rritja e numrit të mësuesve ndihmës, kërkon mbështetje për trajnimin e tyre. - Shërbimi psikosocial: 1 punonjës social/psikolog për 2500/3000 nxënës - Konsideratë në PBA për edukimin e nxënësve, që nuk shikojnë
-Rinia -	
- Rinia sektor crosscutting, buxheti për të i konsiderueshëm. Vijon të shënojë rritje(konsideratë arsimi) - Kërkesa e tregut të punës duhet të lidhet me outputin e arsimit të lartë. - Vazhdojnë investimet dhe shënohet rritje cdo vit në arsim, që do të thotë buxhet i dedikuar për rininë. - Papunësia tek të rinjtë në Shqipëri, më e ulëta në rajon	- Buxheti për rininë vijon të shënojë rënie - Shifrat tregojnë rritje të punësimit, por ndërkaq rinia kërkon të gjejë mundësi jashtë (Brain drain inxhinierë, mjekë etj). Mekanizma parandaluese - Karta e Rinisë rekomandim prej disa vitesh
ÇËSHTJET SOCIALE	
MFE & ML-të Angazhime/Rekomandime	*OSHC Diskutime/Rekomandime*
- ***Buxhetim Gjinor dhe Gratë -***	
- Vetëdije e lartë e qeverisë qëndrore se çështjet gjinore nuk trajtohen me seriozitet. - MFE në pritje të rezultateve të BA vendore, për të definuar drejtim të duhur - Buxhetimi gjinor është përfshirë nga qeverisja qëndrore qysh në dokumentat e 2015-ës, domosdoshmëri përfshirja edhe nga pushteti vendor - Nevojë për mbështetje ndaj Bashkive për tregues barazie gjinore	- Forcim i buxhetimit gjinor
- ***Personat me aftësi të kufizuar (PAK) -***	
- Në proçes targetimin i duhur i PAK, për të nxjerrë nga skema abuzuesit përfitues të kësaj kategorie, për të mirëadministruar dhe rritur cilësinë e shërbimeve . Zbatimi i	- Sugjerimet për arsimin e kategorisë PAK janë marrë në konsideratë në kuota të ulëta - Nevojë për mësues ndihmës për PAK ,

skemës së ri të vlerësimit bazuar në modelin bio-psiko-social, standarde të OBSH - 600 mësues ndihmës; OSHC parashtrim të rekomandimeve pranë MASR, për dijeni MFE - Hapa konkrete për partneritet me binzesin, të mundësoje respektimin e kuotavetë punësimit për PAK - Përfitimet e PAK do të rishikohen dhe do të mundësohet mbështetja me pagesa më të larta të atyre individëve PAK me gjendje shëndetësore më të rënduar dhe kanë barriera për tu integruar në jetën shoqërore. - Incentiva të parashikuara në legjislacion që po përmirësohen për riintegrimin e personave PAK - Kërkohet kontributi i OSHC-ve për një sërë shërbimesh që i ofrohet PAK - Aksesueshmëria ende në nivele të ulëta edhe pse institucione publike po bëjnë hapa konkretë në këtë drejtim	arsimi parauniversitar - Punësimi i PAK kuotat, nuk respektohen nga sektori publik dhe as nga ai privat, 1 në 25 të punësuar duhet të jetë PAK. - Pas 4 vitesh nëse PAK del nga tregu i punës duhet të konsiderohet ti ofrohet asistenca ekonomike - Ndërhyrje për shtimin e qendrave sociale - Në zona të thella të vendit mungesë informacioni, individë që prej +15 vitesh nuk e përfitojnë pagesën,pasi nuk kanë dijeni - Integrimi I PAK fillon me shërbime qysh në moshë të hershëm; Edukimi gjithëpërfshirës ende mangësi - Ligji i shërbimeve shoqërore kaloi herën e parë pa buxhet - Përputhja me konventat ndërkombëtare në praktikë e mangët - Si do përkthehet konkretisht në buxhet ?
- ***Fëmijët -***	
- Përfshirë në PBA. Kërkesat shtesë do të diskutohen e konsiderohen rekomandimet - Buxhetimi i fëmijëve, vecanërisht fëmijët PAK janë fokus i PBA	- Buxhetim më i lartë për fëmijët - Kostimi i planeve sociale - Shtimi i qendrave sociale për fëmijët - Shërbime konkrete për fëmijët e dhunuar seksualisht - 50 fëmijë shfrytëzohen në punë të zezë, mekanizma identifikues, parandalues e ndëshkues - 4 mije raste dhune raporton për 20174 Avokati Popullit, shërbime konkrete të paqarta, qendra sociale
- ***Shërbimet e Kujdesit Shoqëror / Fondi Social -***	
- Aktualisht 600 mësues ndihmës, parashtroni rekomandimet tuaja MARS, në dijeni MFE - Shërbimet e reja, me synim bashkëpunim efektiv me NjQV-të, për të rritur mbulimin në të dy nivelet e qeverisjes,	- Fondi social, mungesë informacioni për kostimin/buxhetimin e ndihmësve - NJQV kanë mbingarkesë e mungesë kapacitetesh, balancat duhet të mbahen në MSHMS - Rishikim për paketën minimale të shërbimeve sociale
- ***Ndihma ekonomike -***	
- Ndihma ekonomike në të njëjtat nivele, por do të ketë përmirësim ndjeshëm targetimi i familjeve në nevojë (skema pikëzimit - mbështetur nga Banka Botërore) - Anëtarët e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike mbështeten nga buxheti me pagesë për formim profesional - Fokus kalimi nga politikë pasive në politikë aktive, me objektiv integrimin e kësaj kategorie në jetën sociale	- Rënie e ndjeshme e nivelit të ndihmës ekonomike
- ***Ndërrmarrjet sociale -***	
- Mekanizmi i ndërrmarrjeve sociale ende në gjenezë. MSHMS po punon me ligjin	- Ende asnjë hap konkret

- Ndërrmarrjet sociale kërkojnë subvencionim nga shteti - Po konsiderohen eksperiencat më të mira në Evropë - Mbështetja e BE-së dhe fondet mundësi për shtysë	
- ***Strehimi social*** -	
- + 350 milionë Lekë për financimin e strategjisë ekzituese(hyn në fuqi me ligjin e ri), aktivitetet e tjera + 250 milionë. Tavani buxhetor kërkon 2-fishim - PBA ka konsideruar kufizimet buxhetore. Analizë plani dhe nevojat e përfituesve. Takime të veçanta me OSCH-të e aktorët kyç për 2019 - Financimi për strehim në mbështetje të funksionit të QV, kërkohet angazhim nga Bashkitë - Nevojë për tregues të matshëm, edhe në nivel vendor	- Fondi social, mungesë informacioni për kostimin/buxhetimin e ndihmësve - NJQV kanë mbingarkesë e mungesë kapacitetesh, balancat duhet të mbahen në MSHMS - Rishikim për paketën minimale të shërbimeve sociale
SHËNDETËSIA	
MFE & ML-të Angazhime/Rekomandime	*OSHC Diskutime/Rekomandime*
- Mbulim universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor dhe dytësor - Zgjerim i kategorisë së ilaçeve që përfshihen në skemën e rimbursimit - Rritje e cilësisë së shërbimit spitalor e numrit të spitaleve - Nuk lejon buxhetin të parashikojë saktësishst nevojat (shembull 4000-5000raste të reja me tumor/vit , raportohen në vitet e fundit. Sipas standardeve të BE-së kosto për 1 të semurë/30.000 euro/vit; Numri i ulët i lindjeve, por mosha e tretë merr një pjesë të konsiderueshme të buxhetit për mjekim) - Fokus te mbullimi i kujdesit mjekësor të fëmijët dhe gjithëpërfshirja	- Skema e rimbursimit të ilaceve, po identifikon probleme
BUJQËSIA	
MFE & ML-të Angazhime/Rekomandime	*OSHC Diskutime/Rekomandime*
- Fuqizimi i fermerëve, vijimësi e mbështetjes së skemës përmes IPARD - Projekti 100 fshatrat, mundësi si një nga skemat e financimit që ofrohen - Avancim dhe lehtësime për agroturizmin, si sektor me potencial real për zhvillimin ekonomik - Avancim i lehtësirave fiskale, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, ulja e tatim fitimit nga 15 % në 5%	- Kapaciteti absorbimit ende i ulët - Lehtësira dhe aksesueshmëri më të mëdha në program për fermerët e mesëm e të vegjël - Trajnime dhe konsultime për lehtësi dhe aksesueshmëri të fermerëve të mesëm dhe të vegjël
TË NDRYSHME	
OSHC Diskutime/Rekomandime	

-Proçesi i konsultimeve me publikun duhet të reflektohet nga institucionet dhe të paraqesin një raport, si janë konsideruar rekomandimet e OSHC-ve.

- Jo të gjitha Ministritë dhe institucionet, po shprehin gatishmëri për konsultime me publikun

MFE & Ministritë e Linjës(ML) | Angazhime dhe Rekomandime

Fillimet e implementimit të buxhetimit me pjesëmarrje (qytetari përmes përfaqësisë së shoqërisë civile). Hapja e qeverisë ndaj qytetarit dhe OSHC-ve në këtë PBA është praktika e parë në këto 25 vite dhe do të vijojnë si një seri e pandalshme e një buxheti gjithëpërfshirës e transparent

- ✓ MFE angazhohet se do të nxisë ministritë e linjës të zhvillojnë dëgjesa e takime me OSHC-të për PBA 2019-2021, për t' hapur rrugë e kontribuar në shtyllën e SMPF për transparencë e gjithëpërfshirje. MFE po shqyrton mundësitë dhe rrugët e duhura për të krijuar këtë akses OSHC-ve.
- ✓ MFE kërkon dhe nxit OSHC-të për një rol aktiv dhe propozime konkrete që ofrojnë zgjidhje dhe janë të prekshme , duke përfaqësuar interesin e qytetarit dhe ofruar kontribut real në aderesimin e zhvillimit ekonomi. MFE sugjeron që OSHC-të të bashkohen sipas sektorëve dhe të ofrojnë propozimet e tyre në një dokument /sektor jo vetëm në buxhetin qëndror por edhe atë vendor. Do të krijonte lehtësira dhe do të rriste impaktin e shoqërisë civile për rekomandimet respektive
- ✓ Diskutimet rreth buxhetit, nuk duhet të limitohen në diskutime rreth reduktimit apo nevojës për rritje. Përqasja dhe filozofia që qëndron pas buxhetit duhet të përkthehet në qytetarë realë që ndikohen nga buxheti
- ✓ MFE nxit e rekomandon OSHC-të të përdorin dritaren ligjore duke qenë pjesëmarrëse active pranë qëverisë qëndrore . Ligji I menaxhimit të sistemit buxhetor lejon në periudhat Mars-Prill të vitit, përfshirjen e OSHC-vë për diskutime, sugjerime dhe reflektime në buxhet
- ✓ MFE & ML-të konsiderojnë kyç monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, me nevojë reale për indikatorë të qartë matshmërie. Ka matje nga zyrtarët dhe qeveria qëndrore, por një vlerësim i pavarur nga OSHC-të për rritjen e përgjegjshëmërisë konsiderohet rëndësi rëndësi së veçantë.
- ✓ MFE nxit OSHC-të për sugjerime konkrete se si mund të rritet aksesi për të përmirësuar cilësinë e financave publike

Aneksi 4 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor

Bazuar në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në Udhëzimin të Ministrit të Financave nr.7 datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", janë identifikuar **25 programe buxhetore** gjatë fazës strategjike të përgatitjes së dokumentit të PBA 2019-2021 që përfshijnë buxhetimin gjinor në kërkesat e tyre për PBA. Më konkretisht:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. *Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"*

   Qëllimi "Rritja, forcimi dhe zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese për një planifikim, menaxhim dhe administrim të politikave dhe strategjive në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e barazisë gjinore dhe mosdikriminimit"

   Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Politika dhe/ose strategji sektoriale te miratuara në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit	1	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Numri i programeve buxhetore qe përfshijnë elementë gjinorë	2	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Personel gra të promovuara në nivele drejtuese	50%	50%	50%	50%

   Objektivi "Proceset e rekrutimit të punonjësve të rinj dhe rritjes në detyrë, respektojnë parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit"

   Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Personel burra të rekrutuar rishtazi (%)	50%	50%	50%	50%
Personel gra të rekrutuara rishtazi (%)	50%	50%	50%	50%
Personel burra të trajnuar (%)	50%	50%	50%	50%
Personel gra të trajnuara (%)	50%	50%	50%	50%
Raste diskriminimi të trajtuara (%)	0%	0%	0%	0%

2. *Programi "Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor"*

Objektivi 1 "Ofrimi për fermerët i kartave dhe paketave teknologjike me elementë të përmirësuar dhe rekomandime të dala nga studimet e kryera nga QTTB-të"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Përqindja e të grave fermere të informuara përmes strukturave të Agjensive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor kundrejt numrit total të fermerëve të informuar	10%	trend rritës	trend rritës	trend rritës

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 5	Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik			
Sasia	250	270	290	320
Kosto totale (në mijë lekë)	1400	1550	1600	1650

3. *Programi "Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun"*

Objektivi 1 "Rritje e konkurueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe zhvillimit të zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Numri i përfitueseve gra të mbështetura	Vlera bazë	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës

Objektivi 3 "Zhvillimi ekonomik në hapësirën rurale të 100 fshatrave me potenciale më të larta zhvillimi, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë nëpërmjet koordinimit të ndërhyrjeve zhvillimore"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Treguesi 2 Numri i të punësuarëve gra/vajza	...	30	50	100

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

4. *Programi "Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor"*

Objektivi 8 "Rritja e përfaqësimit të grave në strukturat e shërbimit të jashtëm"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Numri i grave në strukturat e shërbimit të jashtëm MEPJ dhe përfaqësitë diplomatike	175	177	178	180
Numri i grave në poste të nivelit drejtues dhe ekzekutiv strukturat e MEPJ-së	29	31	31	32
Numri i grave në poste drejtuese të përfaqësive diplomatike	13	15	15	16

Ministria e Kulturës

5. *Programi "Arti dhe Kultura"*

Objektivi 1 "Mbështetja, mbrojtja dhe promovimi i vlerave me perfaqësuese kulturore përmes rritjes së numrit të aktiviteteve, rritjes se audiencave, bartësve dhe pjesëmarrjes në zbatim të politikës së programit"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Raporti i grave artiste të mbështetura financiarisht ndaj totalit të përfituesve	40%	trend rritës	trend rritës	trend rritës

6. *Programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë"*

Objektivi 2 "Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Raporti i grave artizane të mbështetura financiarisht ndaj totalit të përfituesve	33%	35%	trend rritës	trend rritës

Ministria e Brendshme

7. *Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"*

Objektivi 1 "Sigurimi i menaxhimit efiçent dhe efektiv të burimeve financiare, njerezore dhe materiale në strukturat e Ministrisë"

Produkti:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Produkti 5	Femra të përfaqësuara në nivelet drejtuese të ministrisë			
Sasia	31	31	31	31
Kosto totale (në mijë lekë)	35,500	39,427	40,027	40,027

8. *Programi "Policia e Shtetit"*

Objektivi 1 "Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit dhe terrorizmit"

Produkti:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Produkti 3	Masa mbrojtëse te menjëhershme te ndaj grave dhe vajzave			
Sasia	2,284	2,363	2,445	2,530
Kosto totale (në mijë lekë)	50,248	50,734	51,238	51,759

Objektivi 2 "Rritja e sigurisë publike dhe forcimi i kontrolli te territorit e policimit ne komunitet"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Shpejtësia e reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje	20 minuta	18 minuta	16 minuta	14 minuta

Objektivi 3 “Reduktimi i trafiqeve, krimit ndërkufitar dhe rastet e imigrimit te paligjshëm”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Azilkërkues gra të trajtuar në qendrën e pritjes	15	25	35	50
Azilkërkues burra të trajtuar në qendrën e pritjes	250	300	350	400

Objektivi 4 “Rritja e standardeve për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve sipas standardeve të BE-se dhe Kodit Schengen”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Staf gra në PKK	12% ndaj totalit ose 197 femra	12,4% ndaj totalit ose 202 femra	12,7% ndaj totalit ose 207 femra	13% ndaj totalit ose 212 femra
staf burra në PKK	88% ndaj totalit ose 1438 meshkuj	87.6% ndaj totalit ose 1433 meshkuj	87.3% ndaj totalit ose 1428 meshkuj	87% ndaj totalit ose 1423 meshkuj

Objektivi 5 “Përafrimi i standarteve të shërbimeve policore me ato të BE-së”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Gra te arsimuara ne Akademine e Sigurise ndaj totalit	8 % ndaj totalit	16% ndaj totali	28% ndaj totali	41% ndaj totali
rekrutë gra ndaj totalit te rekrutëve	26.5 % ndaj totalit	14.8% ndaj totalit	27.8% ndaj totalit	31.8% ndaj totalit
Numer i femrave / totalit ne strukturat e Policise se Shtetit	1513	1566	1616	1666
Raporti i efektiveve policore femra ne pozicione drejtuese / totalit te drejtuese	2.5 % ose 39/1523	2.5 % ose 39/1523	3 % ose 45/1523	3.5 % ose 53/1523

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 3	Bashkëshorte te trajtuara			
Sasia	112	112	112	112
Kosto totale (në mijë lekë)	39,801	39,801	39,801	39,801

Ministria e Mbrojtjes

9. *Programi "Forcat e luftimit"*

Objektivi 1 "Mbajtja në gadishmëri dhe përmiresimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Tokësore"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Përqindja e grave në forcat tokësore	5%	6%	7%	8%

Objektivi 2 "Mbajtja në gadishmëri dhe përmiresimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Detare"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Përqindja e grave në forcat detare	10%	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës

Objektivi 3 "Mbajtja në gadishmëri dhe përmiresimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Ajrore"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Përqindja e grave në forcat ajrore	18%	konstant	konstant	konstant

10. *Programi "Mbështetja e Luftimit"*

Objektivi 1 "Sigurimi i logjistikes së nevojshme si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare"

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 8	Bashkëshorte të ushtarakëve të mbështetura financiarisht			
Sasia	57	57	57	57
Kosto totale (në mijë lekë)	16,269	16,269	16,269	16,269

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

11. *Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"*

Objektivi 1 "Sigurimi i standarteve të kujdesit shëndetësor"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Numri i grave në pozicione vendimmarrëse	10%	trend rritës	trend rritës	trend rritës

12. *Programi "Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor"*

Qëllimi "Mbulimi universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Jetëgjatësia mesatare e burrave	77	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Jetëgjatësia mesatare e grave	80	trend rritës	trend rritës	trend rritës

Objektivi 1 "Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Gra shtatzëna që marrin vizitën e parë të detyrueshme brenda 3-mujorit i të shtatzënisë ndaj totalit të shtatzënave	1	trend rritës	trend rritës	trend rritës
% e grave mbi 35 vjec të depistuara për kancer gjiri	0	trend rritës	trend rritës	trend rritës
gra te grupmoshes 40-70 vjec që përfitojnë nga shërbimi i check-up	0.61	0.5	0.5	0.5

13. *Programi "Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor"*

Qëllimi "Mbulim universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Jetëgjatësia mesatare e burrave	77	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Jetëgjatësia mesatare e grave	80	trend rritës	trend rritës	trend rritës

Objektivi 1 "Ofrimi cilësor dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Raste të kancerit të gjirit të trajtuara ndaj të totalit të diagnostikuar	450	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Pacientë të trajtuar në maternitete shtetërore	50892	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Raporti i numrit të seksio cezarea ndaj numrit total te lindjeve në institucionet publike	40%	trend zbritës	trend zbritës	trend zbritës
Indeksi i vdekshmërisë foshnjore	5.3 për 1000 lindje të gjalla	trend zbritës	trend zbritës	trend zbritës
Indeksi i vdekshmërisë foshnjore (femra)	2.7 për 1000 lindje të gjalla	trend zbritës	trend zbritës	trend zbritës
Indeksi i vdekshmërisë amtare	10.9 për 100.000 lindje	trend zbritës	trend zbritës	trend zbritës

14. *Programi "Programi "Shërbime të shëndetit publik"*

Qëllimi "Mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetës së shëndetshme"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Jetëgjatësia mesatare e burrave	77	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Jetëgjatësia mesatare e grave	80	trend rritës	trend rritës	trend rritës

Objektivi 3 “Depistimi i kancerit të gjirit”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Vdekshmëria nga kanceri i gjirit	16,2/100.000	16,2/100.000	16,2/100.000	16/100.000
Mbulimi i grave me shërbim të depistimit të kancerit të gjirit	9%	13%	17%	19%

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 1	Depistimi për kancerin e gjirit			
Sasia	5,000	5,200	5,400	5,800
Kosto totale (në mijë lekë)	8,400	8,827	9,285	9,988

15. *Programi “Përkujdesi social”*

Objektivi 1 “Reformimi i programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij : NE, PAK dhe shërbimet sociale”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
% e përfituese të grave kryefamiljare që marrin NE mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare	12%	trend rritës	trend rritës	trend rritës
Gra dhe vajza në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social	66	trend rritës	trend rritës	trend rritës

16. *Programi “Përfshirja Sociale”*

Qëllimi “Krijimi i mundësive dhe aksesit të barabartë për burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë dhe gjithë grupet e margjinalizuara, nëpërmjet fuqizimit social ekonomik dhe integrimit në shoqëri, për rritjen e mirëqënies ekonomike dhe sociale”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Hendeku gjinor i pages	6%	trend zbrites	trend zbrites	trend zbrites

Objektivi 1 "Përfshirja e barabartë sociale dhe ekonomike e burrave dhe grave, fëmijëve dhe grupeve të margjinalizuara"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Raste te trajtuar me urdher te menjehershem te mbrojtjes /Raste të denoncuara te dhunës në familje	57%	trend zbritës	trend zbritës	trend zbritës

Ministria e Drejtësisë

17. *Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"*

Objektivi 5 "Dhënia e ndihmës juridike për individët që plotësojne kushtet, në zbatim te ligjit për Ndihmën Juridike"

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 1	Ndihme juridike falas per femrat ne nevoje			
Sasia	300	350	400	450
Kosto totale (në mijë lekë)	11,000	11,000	11,000	11,000

18. *Programi "Sistemi i burgjeve"*

Qëllimi "Për një sistem burgjesh që garanton të drejtat dhe liritë themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe siguron reintegrimin e tyre në shoqëri"

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Norma e recidivitetit (burra)	11%	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës
Norma e recidivitetit (gra)	1%	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës

Objektivi 1 “Sigurimi i standardeve të ofrimit të shërbimit të ekzekutimit të veprave penale”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Numri i trupës policore në raport me numrin e të burgosurave gra	2%	2%	2%	2%
Numer i trajtuar për femijet që lindin ose vijnë me nënat e burgosura	1%	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 2	Të burgosura gra të trajtuar në IEVP			
Sasia	96	96	96	96
Kosto totale (në mijë lekë)	94,431	94,431	94,431	94,431

Objektivi 2 “Reintegrimi i të dënuarve”

Treguesit e Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Rehabilitimi i të dënuarve dhe përgatitja e tyre për reintegrim në shoqëri (numri i kurseve të aftësimin profesional për të dënuar burra)	6%	Trend rritës	trend rritës	trend rritës
Rehabilitimi i të dënuarve dhe përgatitja e tyre për reintegrim në shoqëri (numri i kurseve të aftësimin profesional për të dënuar gra)	40%	Trend rritës	trend rritës	trend rritës

19. *Programi “Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor”*

Objektivi 2 “Ekzekutimi 100% i cdo urdhër mbrojtjeje në favor të femrave”

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Tituj ekzekutive të depozituar në lidhje	220	220	220	220

me urdhrat e mbrojtjes në favor të femrave				
Tituj ekzekutive të ekzekutuar në lidhje me urdhrat e mbrojtjes në favor të femrave	220	220	220	220

20. *Programi "Shërbimi i provës"*

Objektivi "Rritja e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standarteve më të larta në fushën masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të denuarve me masa alternative"

Produkti:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Produkti 3	Gra të dënuara të mbikqyrura			
Sasia	564	565	565	565
Kosto totale (në mijë lekë)	15,047	15,147	15,647	15,847

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

21. *Programi "Fonde për Shkencën"*

Objektivi 2 "Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejte të 3200-3800 kërkuesve, ku prioritet kanë kërkueset femrat, si dhe mbështetje financiare për kërkim fondamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Numri i kërkuesve që kanë përfituar financim	3000	3200	3400	3600

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

22. *Programi "Arsimi i Mesëm Profesional"*

Objektivi 1 "Rritja e aksesit në Arsimin e mesëm profesional"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Numri i nxënësve femra që ndjekin AP	2921	3000	3100	3200

23. *Programi "Tregu i Punës"*

Objektivi 1 "Përmiresimi i fushës së shërbimeve të punësimit (të ndërmjetësimeve, këshillimeve dhe orientimit për karrierë) targetimi i grupeve në nevojë të të papunëve"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Punëkërkuese të punësuara nga programi i nxitjes së punësimit për gratë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe vajzave nëna (VKM 27)	200	300	300	300

24. *Programi "Menaxhimi i Shpenzimeve Publike"*

Objektivi 1 "Mirëplanifikim i shpenzimeve dhe mirëadministrim i të ardhurave, duke reflektuar një rritje ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme. Përmiresimi i cilësise së Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe të procesit të përgatitjes së këtij dokumenti gjatë fazës Strategjike dhe Teknike të tij"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Numri i Programeve Buxhetore qe përfshijnë efektivisht Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor	28	Trend Rrites	Trend Rrites	Trend Rrites

Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi

25. *Programi "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"*

Objektivi 2 "Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve, institucioneve dhe organizatave me interesa legjitime, në Shqipëri, lidhur me mbrojtjen nga dsikriminimi dhe rolin e KMD-së dhe bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm"

Treguesi i Performancës:

	2018 Buxheti	**2019 Parashikimi**	**2020 Parashikimi**	**2021 Parashikimi**
Rritja e numrit të ankesave	2%	4%	5%	6%

Produkti:

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Produkti 1	Qytetarë të ndërgjegjësuar			
Sasia	1000	1500	2000	2500
Kosto totale (në mijë lekë)	6,237	6,237	6,437	6,537

Metodologjia e re e përgatitjes së buxhetit, ka mundësuar përfshirjen e elementëve gjinorë jo vetëm në terma të objektivave dhe produkteve, por edhe të treguesve të performancës sin ë nivel qëllimi edhe në nivel objektivi. Në këtë mënyrë, do të krijohet mundësia e vlerësimit jo vetëm të kostove të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, por edhe të rezultateve dhe impakteve që shpenzimet buxhetore, kanë në jetën sociale-ekonomike të grave në Shqipëri.

Proçesi i përfshirjes efektive të buxhetimit gjinor në kërkesat buxhetore të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera buxhetore do të vijojë në mënyrë aktive në vazhdimësi, nëpërmjet dhe asistencës së zyrës së UN Women në Shqipëri, duke u fokusuar sidomos në përsosjen e mekanizmave të monitorimit të ecurisë së politikave gjinore të identifikuara nga programet e sipërcituara, ashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së treguesve të performancës për këto programe.

ANEKS 5 Transferta e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore

a) mënyra e llogaritjes dhe shuma e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike të njësive të qeverisjes vendore;

Transferta e pakushtëzuar

Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për vitet 2019-2021, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat të cilat janë transferuar në pushtetin vendor. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i tranfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Në përllogarritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar merren si kritere: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km^2, numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Transferta e pakushtëzuar i siguron njësive të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal).

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të njësive të vetëqeverisjes vendore duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi (që kap diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.

Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet.

Tabela 1. Transferta e Pakushtëzuar për periudhën 2019-2021

në milionë lekë

Nr	Vitet	2019	2020	2021
1	Transferta e Pakushtëzuar	16,848	17,981	19,604

Transferta Specifike

Pjesë e transfertës specifike janë fondet të cilat iu transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore nga

pushteti qendror. Financimi i këtyre funksioneve parashikohet për një periudhë tranzitore 1-3 vjet. Detajimi i fondeve dhe i numrit të punonjësve për çdo funksion është bërë duke u bazuar në strukturën ekzistuese të ushtrimit të funksionit në ministrinë përkatëse, para transferimit të tyre në pushtetin vendor.

Funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Tabela 2. Transferta Specifike për periudhën 2019-2021

në milionë lekë

Nr	Vitet	2019	2020	2021
1	Transferta Specifike	7,300	7,300	7,200

b) shuma dhe qëllimi i transfertës së kushtëzuar, që Buxheti i Shtetit jep për njësitë e qeverisjes vendore;

Qëllimi i transfertës së kushtëzuar është financimi i shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara është rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës, nga ministritë përkatëse të linjës.

c) taksat kombëtare, të ndara me qeverisjen vendore, dhe pjesën e ndarë për tre vitet pasardhëse buxhetore.

Një ndër taksat kombëtare, një pjesë e së cilës i transferohet njësive të vetëqeverisjes vendore është taksa e rentës mineare. Bazuar në ligjin nr.157/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 'Për taksat kombëtare', të ndryshuar", 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria minerare. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Bazuar në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", njësië e vetëqeverisjes vendore do të përfitojnë si taksë të ndarë, 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Tabela 3. Taksa e ndara për periudhën 2019-2021

në milionë lekë

Nr	Vitet	2018	2019	2020
1	Të ardhurat nga taksat e ndara	650	650	650